Во оваа смисла, беше изготвен и Посебен извештај адресиран до Националниот координатор во Комисијата за трговија со луѓе и илегална миграција, а во прилог на Извештајот беше доставен и дополнителен извештај за проценка на состојбата со менталното здравје и психосоцијалните потреби на задржаните лица во привремениот транзитен центар, изготвен од специјалист по медицинска психологија кој беше дел од тимот на НПМ за време на посетата.

Во Привремениот транзитен центар „Табановце“ бројот на лица коишто се сместуваат постојано варира и е променлив на дневна основа, а за време на

посетата што тимот на НПМ ја спроведе на 01.04.2021 г. немаше сместено ниту едно лице. Тоа се должи, пред сè на фактот што се работи за Центар од отворен карактер каде што на лицата генерално им е дозволено да се сместат и да заминат кога сакаат. Исто како во ПТЦ „Винојуг“ и во ПТЦ „Табановце“ има постојано присуство на лекарски тим, претставници од Министерството за труд и социјална политика, како и претставници на меѓународни и невладини домашни организации коишто на задржаните лица им овозможуваат пристап до услуги коишто се во рамки на нивниот делокруг на работење.

Прифатниот центар за странци во Гази Баба, тимот на НПМ го посети два пати во текот на 2021 година. За време на првата посета, којашто беше извршена на 25 март беа задржани 3 лица, додека при повторната посета на 21 мај беа затекнати вкупно 52 задржани лица. За време на посетите беше констатирано извесно подобрување во делот на материјалните услови, но и понатаму останува забелешката дека Центарот не ги исполнува условите согласно намената за којашто се користи. Активностите за изградба на нов Прифатен центар беа прекинати со одлуката на Владата на Р.С. Македонија во октомври 2021 год., поради поплаките на жителите од местото каде што требаше да се гради. Во делот на постапувањето со странците коишто се сместуваат во Центарот, тимот на НПМ констатира дека и понатаму еден од најголемите проблеми претставува основот за нивно задржување. Во оваа смисла, за време на посетите беше констатирано дека некои од странците беа задржани поради наводно сторено кривично дело, иако тоа не претставува основ за задржување на странец во Прифатен центар за странци.

За време на посетата во Прифатниот центар за баратели на азил во Визбегово, тимот на НПМ констатираше дека беа сместени вкупно 21 лице. Со оглед на капацитетот, којшто е за околу 150 луѓе, голем број на слободни сместувачки капацитети беа празни. Во Прифатниот центар преку претходно спроведена јавна набавка е постојано ангажиран лекар од приватна здравствена установа којшто е присутен во Центарот секој ден, во смени (еден ден прва смена, нареден ден втора смена), а по потреба и за време на викенди. За секој барател на азил има отворено посебно здравствено досие, а исто така се води и посебен медицински дневник во којшто се внесуваат сите извршени прегледи. Кога има потреба од специјалистички прегледи се издава упат, а сите трошоци потоа се фактурираат и покриваат од страна на Центарот. Здравствената амбуланта е соодветно опремена со неопходната медицинска опрема и лекови. За време на посетата не беа добиени информации за какви било насилни инциденти во Центарот, а во оваа смисла, од страна на директорот беше истакнато дека биле обезбедени и средства за ангажирање на надворешна агенција за обезбедување заради спречување на поголема ескалација во услови кога евентуално и би дошло до такво нешто, како што имало случаи во минатото. Барателите на азил имаат можност сите забелешки или поплаки поврзани со третманот во Центарот непосредно да ги истакнат пред педагозите, психолозите, социјалните работници, како и непосредно до директорот. На нив не им е ограничена слободата на движење, ниту пак, имаат какво било ограничување во контакти со трети лица надвор. Во оваа смисла, имаат и можност слободно да се обратат до сите институции, организации и лица во случаите кога би имале какви било поплаки

поврзани со нивното сместување, постапување и третман додека се корисници на услугите во Прифатниот центар.

Имајќи предвид дека во вршењето на граничниот надзор и особено во делот на справувањето со нерегуларната миграција на македонските полициски службеници им помагаат и странски полициски сили од Австрија, Чешка, Словенија, Словачка, Хрватска, Унгарија и Полска, НП-НПМ во рамки на мандатот и надлежностите да го следи постапувањето со лицата лишени од слобода заради утврдување на фактичката состојба и анализирање на истата од аспект на евентуално постоење индикатори што би можеле да упатуваат на зголем ризик од несоодветно постапување спрема овие лица, достави допис во вид на прашалник до Министерството за внатрешни работи, со барање до надлежниот орган да одговора на прашања поврзани со овластувањата на странските полициски службеници да употребуваат оружје и средства за присилба, како и нивната одговорност во однос на пречекорување на нивните овластувања.

Конкретно, во однос на упатените прашања, до НП – НПМ од страна на министерот за внатрешни работи беа доставени образложени одговори, кои во овој Извештај ги пренесуваме сублимирано. Имено, во однос на тоа кои видови на средства за присилба и оружје имаат право да ги користат странските полициски службеници, во одговорот е наведено дека странските полициски службеници на територијата на Република Северна Македонија имаат право да го користат своето лично вооружување, како и средства за присилба кои се предвидени во Законот за полиција во Република Северна Македонија.

Понатаму, во одговорот на поставените прашања, е наведено дека странските полициски службеници работните задачи ги извршуваат исклучиво во мешани патролни тимови утврдени во Наредба за вршење мотопатролна дејност. Па така, е наведено дека во секој мешан патролен тим задолжително има присуство на најмалку еден полициски службеник од Република Северна Македонија кој има улога на водич на патролниот тим и е одговорен за сите постапки кои ќе бидат преземени од страна на членовите на мешовитиот патролен тим (странските полициски службеници).

Во одговорот е наведено дека странските полициски службеници смеат да употребат службено оружје и средства за присилба исклучиво во присуство и по претходна согласност и одобрување од страна на македонскиот полициски службеник кој е одговорен во тимот, а врз основа на претходно исполнети услови за употреба на наведените средства (огнено оружје/средства за присилба), согласно Законот за полиција. Главна одговорност за проценката на исполнетоста на условите за употреба на наведените средства (огнено оружје/средства за присилба) согласно Законот за полиција има македонскиот полициски службеник во мешовитиот патролен тим. Генерално, странските полициски службеници имаат улога на поддршка на македонскиот полициски службеник во извршувањето на службените задачи и примената на полициските овластувања.

Понатаму, е наведено дека обврска за изготвување на извештај за употреба на огнено оружје или средства за присилба во случај на нивна употреба има македонскиот полициски службеник. Оправданоста на истата **се оценува од страна** на непосредниот раководен полициски службеник.

Според доставениот одговор од МВР, странските полициски службеници кои престојуваат на територијата на Република Северна Македонија заради учество во заедничката операција за засилен надзор на јужната граница немаат никаков гарантиран имунитет за постапките кои се преземаат од нивна страна, односно истите се должни да постапуваат **согласно законските прописи кои ја регулираат** работата на припадниците на полицијата во Министерството за внатрешни работи.

Додека, во однос на поставеното прашање, кој е овластен и одговорен за поведување и водење на постапката против странските полициски сили во случај на евентуално постоење наводи за нивно инволвирање во дејствија што би можеле да се подведат под поимот на мачење и друг вид на сурово, нечовечко или понижувачко постапување или казнување, Министерството не достави одговор.

Општи констатации и препораки во однос на постапувањето со странците/мигрантите со нерегулиран престој на територијата на РСМ

Констатирани состојби

- Голем број од лицата коишто се затекнати со нерегулиран статус, односно престој на територијата на Р.С. Македонија се приведуваат, односно лишуваат од слобода и спроведуваат до(пред) полициските станици од општа надлежност каде што не се заведуваат како такви во евиденциите за приведени, односно лишени од слобода или задржани, ниту пак воопшто се известуваат за нивните права на јазик што го разбираат;
- Продолжува праксата на арбитреното задржување во ПТЦ „Винојуг“, без да им се издадат индивидуални решенија на задржаните лица, коишто би содржеле податоци за причините, периодот на задржување, поука за права и слично.

Препораки за подобрување на констатираните состојби

- Секое приведување и лишување од слобода на лице коешто е затекнато со нерегулиран статус, односно престој на територијата на Р.С. Македонија, мора да биде евидентирано во евиденциите на полициската станица во којашто е распределен полицискиот службеник што го извршил приведувањето, односно лишувањето од слобода;
- Веднаш да престане праксата на сместување и задржување лица без да постои за тоа индивидуално решение во коешто ќе бидат наведени причините за сместувањето/задржувањето, времетраењето на задржувањето, можноста и рокот за обжалувањето на таквото решение и пристапот до правна помош.

Анекс 1: Преглед на активности на Националниот превентивен механизам во 2021 година

- превентивни посети
- посети во рамки на проект
- домашни и меѓународни активности

Датум	Место	Активност	Учесници	Организатор
25.03.2021	Скопје	Посета на ПЦ Гази Баба	НПМ	НПМ
25.03.2021	Скопје	Посета на Прифатен центар за баратели на азил – Визбегово	НПМ	НПМ
12.05.2021	Куманово	Затвор Куманово	НПМ	НПМ
17.05.2021	Охрид	Затвор Охрид	НПМ	НПМ
08.06.2021	Кафасан	ПС за ГК и ГН „Кафасан“	НПМ	НПМ
09.06.2021	Табановце	ПС за ГК и ГН „Табановце“	НПМ	НПМ
14.07.2021	СВР Струмица	ПС ОН Радовиш	НПМ	НПМ
		ПС ОН Струмица	НПМ	НПМ
15.07.2021	СВР Струмица	ПС ОН Валандово	НПМ	НПМ
		ПС ОН Гевгелија	НПМ	НПМ
13.10.2021	СВР Охрид	ПС ОН Кичево	НПМ	НПМ
14.10.2021	СВР Охрид	ПС ОН Струга	НПМ	НПМ
		ПС ОН Охрид	НПМ	НПМ
15.10.2021	СВР Охрид	ПС ОН Дебар	НПМ	НПМ
10.09.2021	Деве Баир	ПС за ГК и ГН „Деве Баир“	НПМ	НПМ
15.09.2021	Богородица	ПС за ГК и ГН „Богородица“	НПМ	НПМ
17.19.2021	Гевгелија	ПТЦ „Винојуг“	НПМ	НПМ
24.19.2021	Скопје	ПС за ГП на Меѓународниот аеродром во Скопје	НПМ	НПМ
29-30.09.2021	Будимпешта	Втор состанок на мрежата на националните превентивни механизми од Југоисточна Европа во 2021 година	НПМ	НПМ - Унгарија
05.11.2021	Тетово	Затвор Тетово	НПМ	НПМ
10.11.2021	Струмица	Затвор Струмица	НПМ	НПМ
11.11.2021	Куманово	Затвор Куманово	НПМ	НПМ
15.11.2021	Гевгелија	Затвор Гевгелија	НПМ	НПМ
18.11.2021	Скопје	Затвор Скопје	НПМ	НПМ
23.11.2021	Битола	Затвор Битола	НПМ	НПМ
24.11.2021	Охрид	Затвор Охрид	НПМ	НПМ
25.11.2021	Струга	КПД Струга	НПМ	НПМ
03.12.2021	Штип	КПД Штип	НПМ	НПМ
07.12.2021	Прилеп	КПД Прилеп	НПМ	НПМ
16-17.12.2021	Скопје	КПУ-КПД „Идризово“	НПМ	НПМ
21.12.2021	с. Волковија	ВПД Тетово	НПМ	НПМ
28.12.2021	Охрид	Затвор Охрид	НПМ	НПМ

Анекс 2: Надворешни соработници на Националниот превентивен механизам

1. проф. д-р Дивна Илиќ Димоски од Правниот факултет “Јустинијан Први” при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ – Скопје,
2. проф. д-р. Александра Груевска-Дракулевски од Правниот факултет “Јустинијан Први” при Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ – Скопје,
3. проф. д-р Оливер Бачановиќ од Факултетот за безбедност – Скопје
4. проф. д-р Трпе Стојановски од Факултетот за безбедност – Скопје
5. вон. проф. д-р Катерина Крстевска Савовска од Факултетот за безбедност – Скопје
6. проф. д-р. Стојанка Мирчева од Факултетот за безбедност – Скопје,
7. проф. д-р Јонче Ивановски од Факултетот за безбедност – Скопје,
8. проф. д-р Наташа Пеовска од Факултетот за безбедност – Скопје,
9. доц. д-р Ведије Раткоцери од Правниот факултет при Универзитетот на Југоисточна Европа,
10. доц. д-р Блерта Ахмети Арифиди од Правниот факултет при Универзитетот на Југоисточна Европа
11. вон. проф. д-р Ице Илијевски - од Правниот факултет при Универзитетот „Свети Климент Охридски“, – Битола,
12. д-р. Елена Мујоска Трпевска – научен соработник, ЦСИ МАНУ и Претседател на Македонското пенолошко друштво
13. проф. д-р Атанас Козарев од Факултетот за правни науки, меѓународни односи и дипломатија, МИТ Универзитет
14. доцент д-р Самир Салиевски од Факултетот за детективи и безбедност во Американски Универзитет на Европа-ФОН
15. проф. д-р Лилјана Игњатова – Медицински факултет Скопје,
16. д-р Силвана Марковска-Симоска, специјалист по детска и адолесцентна психијатрија,
17. м-р Иво Куновски, специјалист по медицинска психологија.



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

**AVOKATI I POPULLIT
MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL**

RAPORTI VJETOR 2021

Shkup, qershor 2022

Titulli: *Raporti vjetor 2021*

Titulli i origjinalit: Годишен извештај 2021

Editor: Avokati i Popullit i Republikës e Maqedonisë së Veriut

Autor: Vjollca Rushaj, Aleksandar Trenkoski, Bardhyl Limani

Këshilli redaktues: Avokati i Popullit i Republikës e Maqedonisë së Veriut - Mekanizmi Parandalues Nacional

Përkthyes dhe redaktore gjuhësore: Përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Sebahate Sali, Ardian Iseni, Shkelkim Rijani dhe Kimete Kameri

Disenji grafik: Keti Stefkova

Tirazhi: 50



PËRMBAJTJA

Parathënia

1. AVOKATI I POPULLIT – MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL	61
2. AKTIVITETET DHE VIZITAT E REALIZUARA PARANDALUESE NË VITIN 2021	63
3. INSTUTACIONET NDËSHKUESE-KORREKTUESE	65
3.1. Shtëpia edukuese-përmirësuese Tetovë	75
4. STACIONET POLICORE ME KOMPETENCË TË PËRGJITHSHME	85
5. STACIONET POLICORE PËR KONTROLLE DHE MBIKËQYRJE KUFITARE	93
6. MBAJTJA DHE AKOMODIMI I MIGRANTËVE/TË HUAJVE DHE AZILKËRKUESVE	97
Aneksi 1: Pasqyrë e aktiviteteve të Mekanizmit parandalues nacional në vitin 2021	103
Aneksi 2: Bashkëpunëtorët e jashtëm të Mekanizmit parandalues nacional	104

Lista e shkurtesave

AP	Avokati i popullit
AP-MPN	Avokati i popullit si Mekanizëm parandalues nacional
MPN	Mekanizmi parandalues nacional
MD	Ministria e drejtësisë
DES	Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve
INK	Institucioni ndëshkues-korrektues
ENK	Enti ndëshkues-korrektues
SHEP	Shtëpia edukuese-përmirësuese
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
UNHCR	Zyra e Komesariatit të Lartë për refugjatë
MPB	Ministria e punëve të brendshme
SPB	Spektori për punë të brendshme
SKNMHR	Seksioni i krimit ndërkufitar, migracionit, të huajve dhe readmisionit
PP	Prokurori publik
PTHP	Prokuroria themelore publike
ARMV	Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut
QPT	Qendra e përkohshme transitore

Të nderuar,

Para jush është Raporti i njëmbëdhjetë Vjetor i Avokatit të popullit-Mekanizmit parandalues nacional, i cili konfirmon përpjekjet e vazhdueshme për një luftë gjithëpërfshirëse kundër torturës dhe tolerancës zero në rast të ekzistimit të saj.

Vitin raportues e shënoi pandemia e vazhduar e shkaktuar nga virusi Kovid-19, por kjo situatë nuk e pengoi ekipin e MPN-së të monitorojë vazhdimisht veprimin dhe respektimin e të drejtave të personave në vendet e privimit nga liria dhe ndalimit, me qëllim parandalimin e torturës dhe çdo lloji tjetër të trajtimit brutal, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues.

Raporti përmban përshkrimin e situatave në vendet e privimit dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes, në të cilat MPN-ja arriti të kryejë/realizojë vizita gjatë vitit raportues pavarësisht situatës së njohur me pandeminë Kovid-19, si dhe analizë të aktiviteteve të ndërmarra për parandalimin e torturës dhe llojit tjetër të veprimit brutal, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues në këto vende gjatë kohës së pandemisë.

Situatat e konstatuara dhe rekomandimet e dërguara pranë autoriteteve kompetente për tejkalimin e mangësive të konstatuara janë rezultat i gjithsej 33 vizitave parandaluese, të cilat Mekanizmi parandalues nacional i realizoi gjatë vitit 2021. Praktika e inkorporuar për angazhimin e ekspertëve të profileve dhe institucioneve të ndryshme gjatë këtyre vizitave, kontribuoi për sigurimin e një qasjeje multiprofesionale në punën e Mekanizmit parandalues nacional dhe përforcime plotësuese shtesë të kapaciteteve.



Avokat i popullit

Naser Ziberi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'N. Ziberi', written over a light blue rectangular background.

1

AVOKATI I POPULLIT - MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL

Më datën 30 dhjetor të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Ligjin për ratifikimin e Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të trajtimit brutal, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues dhe caktoi Avokatin e popullit të veprorë si Mekanizëm parandalues nacional.

Në vitin 2009 me ndryshimet e Ligjit për avokatin e popullit, në kuadër të Avokatit të popullit u formua njësi e veçantë organizative-Mekanizmi parandalues nacional (MPN) detyra kryesore e të cilit është parandalimi i torturës dhe llojit tjetër të trajtimit brutal dhe çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues.

Avokati i popullit-Mekanizmi parandalues nacional ka filluar punën më datën 01.04 2011 dhe që nga ajo kohë këtë kompetencë e ushtron përmes analizës së rregullt të trajtimit të personave të privuar nga liria dhe dhënies së rekomandimeve tek organet përkatëse, me qëllim parandalimin e torturës dhe llojeve të tjera të trajtimit çnjerëzor, dhe nëse vlerëson si të nevojshme edhe përmes dërgimit të propozimeve dhe perceptimeve në lidhje me legjislacionin ekzistues ose projektligj.

MPN funksionon si ekip i përbërë nga një këshilltar shtetëror, një këshilltar për parandalimin e torturës, dhe një bashkëpunëtor, ndërkaq me qëllim sigurimin e qasjes multidisiplinare gjatë realizimit të vizitave parandaluese angazhohen dhe përdoren shërbimet nga bashkëpunëtorë të jashtëm, përkatësisht ekspertë të fushave të ndryshme dhe përfaqësues nga disa institucione të arsimit të lartë dhe organizata civile.

Kah fundi i vitit 2020, për realizimin e aktiviteteve të planifikuara në vitin 2021, AP-MPN projekttoi një kornizë buxhetore me lartësi prej 1.225.000,00 denarëve, ndërsa iu miratuan dhe kishte në dispozicion shumë prej 375.000,00 denarëve. Përveç këtyre mjeteve, AP-MPN edhe në vitin raportues 2021 e vazhdoi bashkëpunimin me Zyrën e Komisarariatit të Lartë për refugjatë në Shkup (UNHCR), i cili, ndër të tjera përbëhet edhe

nga donimi i mjeteve të nevojshme për punë dhe monitorim të gjendjes me migrantët, përkatësisht të huajt, azilkërkuesit dhe refugjatët. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, mjetet e donuara nga UNHCR e plotësojnë buxhetin bazë të Institucionit në një masë të caktuar e cila përdoret për qëllimet e projektit dhe forcimin e kapaciteteve të ekipit të MPN-së, Mekanizmit të kontrollit civil dhe Mikut të gjykatës.

Buxhetin të cilin e kishte në dispozicion MPN tërësisht u dedikua dhe shfrytëzua për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe për shpenzimet e publikimit të raportit¹ vjetor. Mirëpo, përveç kryerjes së vizitave parandaluese në vendet e privimit të lirisë, MPN ka mandat të zhvillojë aktivitete promovuese, edukative dhe ndërkombëtare, për të cilat në Buxhetin e dedikuar për MPN-në nuk janë parashikuar mjete të mjaftueshme. Mjetet buxhetore të parapara janë të pamjaftueshme edhe në pjesën për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e vizitave dhe për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare në kuadër të rrjeteve dhe organeve në të cilat është anëtar MPN-ja, dhe në këtë kuptim, Avokati i popullit është i mendimit se për ushtrimin e kompetencave të MPN-së nevojiten burime njerëzore shtesë, materiale dhe financiare të cilat do të sigurohen nga Buxheti i RMV-së, me anë të të cilave do të përjashtohet, përkatësisht reduktohet nevoja që MPN-ja të punojë me mjete të marra përmes donacioneve.

Në këtë kuptim, duke qenë se sigurimi i resurseve të mjaftueshme për funksionim pa pengesa është një nga sfidat me të cilat AP-MPN po ballafaqohet prej shumë vitesh, në këtë Raport është e domosdoshme të ritheksohet detyrimi i shtetit që del nga ratifikimi i Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës ku thuhet qartë se:

„Shtetet aderuese marrin përsipër t’i vënë në dispozicion burimet e nevojshme për funksionimin e mekanizmave parandalues nacional.”²

¹ Gazeta zyrtare nr.165/2008

² Neni 18 p.3 nga Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të trajtimit brutal, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues.

2

AKTIVITETET DHE VIZITAT PARANDALUESE TË REALIZUARA NË VITIN 2021

Pandemia e vazhduar e shkaktuar nga virusi Kovid-19, e përcjellur me valën e rritjes së dytë dhe të tretë të numrit të personave të infektuar me virus, ishte vetëm një nga sfidat që ekipi i MPN-së e kishte parasysh gjatë planifikimit, përgatitjes dhe realizimit të aktiviteteve të tij. Në këtë kuptim, me eksperiencën e një viti më parë kur filloi pandemia dhe me përshtatjen e metodologjisë së punës sipas situatës aktuale, ekipi i MPN-së arriti të realizojë aktivitetet e parashikuara dhe pa ndonjë problem të veçantë të kryejë 33 vizita në vendet e privimit dhe ndalimit nga liria.

Përkatësisht, ekipi i MPN-së gjatë vitit 2021 realizoi gjithsej 33 vizita të paparalajmëruara, nga të cilat: 8 vizita në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme në rajonin e Sektorëve të punëve të brendshme (SPB) Strumicë dhe Ohër, 5 vizita në stacionet policore për kontroll apo mbikëqyrje kufitare, 14 vizita në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese, si dhe 6 vizita në vendet ku akomodohen apo ndalohen të huajt dhe azilkërkuësit.

Gjatë realizimit të vizitave parandaluese u angazhuan bashkëpunëtorë të jashtëm nga disa institucione shkencore-arsimore, të cilët me ekspertizën e tyre kontribuan në forcimin e profesionalizmit dhe ofrimin e një qasjeje multidisiplinore në punë.

Duke marrë parasysh parimet themelore gjatë realizimit të vizitave parandaluese, përshtatja e metodologjisë së punës ishte bërë në bazë të pranimin të praktikave më të mira të ndara në takimet ku morën pjesë anëtarët e ekipit të MPN-së me kolegë nga rajoni dhe më gjërë, si dhe në bazë të rekomandimeve të organizatave dhe organeve përkatëse ndërkombëtare, veçanërisht të Nënkomitetit të OKB-së për parandalimin e torturës.

Për sa i përket aktiviteteve ndërkombëtare në vitin 2021, përfaqësuesit e Avokatit të popullit-Mekanizmi parandalues nacional morën pjesë aktive në disa konferenca dhe pu

nëtori që u mbajtën online, përkatësisht në mënyrë virtuale nga distanca me përmbajtje të ndryshme tematike. Ekipi i Mekanizmit parandalues nacional gjithashtu mori pjesë në takime në kuadër të Rrjetit të MPN-së të Evropës Juglindore. Takimi i parë u mbajt online, ndërsa i dyti u mbajt në Budapest të Hungarisë dhe ishte i kombinuar me prezencë fizike dhe online. Kryesues dhe nikoqir i takimeve ishte MPN-ja e Hungarisë, ndërsa u diskutuan përmbajtje tematike që janë në interes për realizimin e mandatit të mekanizmave parandalues nacional të rajonit. Tema e takimit të parë ishte „Ndikimi i Kovid-19 në aktivitetet e MPN-së, sfidat dhe prioritetet gjatë vizitave, ndërsa tema e takimit të dytë ishte „Teknikat specifike të intervistimit të personave të kategorive vulnerable”, me ç’rast theksi u vu në teknikat e intervistimit për fëmijët, të huajt dhe pjesëtarët e pakicave etnike si dhe për personat me aftësi të kufizuara psiko-sociale dhe LGJBT personat.

Gjatë vitit raportues, përfaqësues të ekipit të MPN-së mbajtën ligjëratë edhe pranë studentëve të Fakultetit juridik pranë Universitetit të Evropës Juglindore.

3

INSTITUCIONET NDËSHKUESE-KORREKTUESE

Trajtimi me personat e paraburgosur dhe të dënuar në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe vlerësimin e shkallës së rrezikut nga tortura dhe trajtimi tjetër brutal, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues, ekipi i MPN-së në vitin 2021 i analizoi përmes realizimit të vizitave të drejtpërdrejta në të gjitha institucionet ndëshkuese-korrektuese, si dhe përmes monitorimit të aktiviteteve që ndërmerren nga ana e autoriteteve dhe që janë në lidhje me situatat dhe funksionimin e sistemit penitenciar.

Në këtë kuptim, ekipi i MPN-së konstatoi se ende ekziston një shkallë e lartë e rrezikut nga tortura dhe trajtimi jo adekuat ose ndëshkimi në institucionet ndëshkuese-korrektuese, gjë që imponon nevojën që autoritetet të tregojnë vullnet të vërtetë dhe të bëjnë përpjekje plotësuese dhe më serioze për realizimin e vizionit të parashikuar në Strategjinë nacionale për zhvillimin e sistemit penitenciar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) 2021-2025, dhe kjo është „Përmirësimi i sistemit penitenciar në përputhje me standardet më të larta evropiane për ekzekutimin e sanksioneve dhe masave alternative“.

Miratimi i Strategjisë nacionale është një nga aktivitetet pozitive të ndërmarra nga ana e autoriteteve gjatë vitit raportues. Ajo parashikon 12 synime strategjike dhe planin e veprimit për zbatimin e tyre, ndërsa për realizimin e suksesshëm, objektiv dhe konsequent të planit të veprimit, vetë Strategjia thekson nevojën për një monitorim dhe evaluim përkatës. Përkatësisht në Strategjinë theksohet se „monitorimi dhe vlerësimi i planit të veprimit mund të realizohet me sukses në qoftë se Qeveria e RMV –së formon grup ndërministror me të cilin do të udhëheq DES (në bashkëpunim me MD), dhe në të cilin do të ketë përfaqësues të Ministrisë së arsimit, Ministrisë së shëndetësisë, Ministrisë së punës dhe politikës sociale, nëpunës të probacionit përfaqësues të organizatave civile dhe të Avokatit të popullit. Iniciativa për formimin e grupit ndërministror është bërë nga ana e

DES, por si e tillë akoma nuk është formuar nga ana e Qeverisë së RMV-së.

AP-MPN në suaza të kompetencave të tij vazhdimisht i monitoron dhe evaluon aktivitetet e autoriteteve lidhur me funksionimin e sistemit penitenciar, por megjithatë konsideron se është e domosdoshme që Qeveria e RMV –së sa më shpejtë ta formojë grupin ndërmintor i cili do të monitorojë dhe evaluojë procesin e realizimit të synimeve të parashikuara strategjike në Strategjinë nacionale.

Në kompetencë të Qeverisë së RMV-së është emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve të institucioneve ndëshkuese-korrektuese, ndërsa Avokati i popullit në të kaluarën shumë herë publikisht ka shprehur kritikë për emërimin e kuadrove joprofesionale dhe partiake në pozicione udhëheqëse në këto institucione. Në korrik të vitit 2021, u publikua Raporti i Komitetit evropian për parandalimin e torturës nga vizita e kryer në RMV,ku poashtu thuhet, ndër të tjera, se „drejtorët e burgjeve dhe zëvendësit e tyre në përgjithësi nuk emërohen në pozitat e tyre në bazë të kompetencës dhe aftësive të tyre“.

AP-MPN rekomandon, në përputhje me standardet ndërkombëtare, se është me rëndësi thelbësore që çdo institucion ndëshkues-korrektues të ketë drejtor profesional, përkatës dhe të kualifikuar dhe jopolitik që është zgjedhur me kujdes për shkak të përshtatshmërisë dhe integritetit të tij për të kryer atë që është një nga detyrat më komplekse në shërbimin publik. Respektimi i rregullave evropiane dhe rregullores nacionale gjatë emërimit të drejtorëve dhe zëvendësve të tyre në institucionet ndëshkuese-korrektuese patjetër duhet të jetë imperativ për çdo qeveri.

Si pjesë e aktiviteteve pozitive të ndërmarra gjatë vitit 2021, AP-MPN thekson veçanërisht miratimin e modularit „Programi për trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm dhe testim të njohurive dhe aftësive të pjesëtarëve të personelit të burgut“, si dhe fillimin e trajnimeve kah fundi i vitit në Qendrën e trajnimit dhe edukimit që gjendet në kuadër të INK-EEK-Idrizovë. AP-MPN në suaza të kapaciteteve të disponueshme do ta monitorojë procesin e trajnimit të personelit të burgut dhe do të përpiqet që ndalimi absolut i torturës dhe llojit tjetër të veprimit brutal, çnjerëzor ose dëgradues ose ndëshkues, si një komponentë esenciale të jetë e përfaqësuar në mënyrë përkatëse dhe të veçantë në Programin për trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm. Gjatë vitit 2021, mbështetur nga Këshilli i Evropës, është organizuar edhe trajnimi për evidentimin e çënimeve të cilat tregojnë veprimin jopërkatës dedikuar për personelin shëndetësor, ndërkaq një trajnim i tillë si një shembull i mirë tematik duhet të bëhet pjesë integrale e Programit për trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm.

Gjatë vitit raportues, DES ka realizuar disa aktivitete për rishikimin e rregulloreve ekzistuese dhe miratimin apo pranimin e rregulloreve të reja, strategjive, protokolleve standardeve operative dhe udhëzimeve për veprimin e personelit të burgjeve dhe në përgjithësi për funksionimin e sistemit penitenciar. AP-MPN i vlerëson pozitivisht këto aktivitete dhe pa e zvogëluar rëndësinë e tyre thekson nevojën që DES të rrisë përpjekjet drejt krijimit të kapaciteteve (njerëzore dhe materiale) për të realizuar pa pengesë synimet, strategjitë, programet dhe planet e parashikuara.

Në këtë kuptim, në vazhdim do të theksohen disa nga konstatimet e notuara gjatë vizitave të cilat ekipi i MPN-së i realizoi në Institucionet ndëshkuese-korrektuese.

Mbipopullimi i të dënuarve është një nga sfidat me të cilat po ballafaqohen prej kohësh disa institucione ndëshkuese-korrektuese në vend. Gjatë vizitave të kryera nga ekipi i MPN-së, gjatë rrjedhës së muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2021, u konstatua se gjysma e institucioneve ndëshkuese-korrektuese po ballafaqohen me mungesë të kapaciteteve akomoduese për personat e dënuar që dërgohen për vuajtjen e dënimit me burg. Në shumicën e institucioneve ndëshkuese-korrektuese, u konstatua se nuk respektohen standardet e parashikuara minimale për akomodim të cilat parashikojnë 4m² për çdo person të burgosur në hapësirë ku janë vendosur më shumë persona.

Prej vitesh situata në ENK Idrizovë është më se shqetësuese dhe nën të gjitha standardet minimale. Më shumë se gjysma e të gjithë të dënuarve ndodhen në këtë institucion,

Tabela nr.1

INK	Kapaciteti për personat e dënuar ³	Gjendje e hasur gjatë vizitës
ENK Idrizovë	1187	1128
ENK Shtip	139	233
ENK Prilep	108	119
ENK Strugë	60	48
Burgu Shkup	128	151
Burgu Tetovë	48	65
Burgu Kumanovë	160	130
Burgu Manastir	77	84
Burgu Strumicë	95	92
Burgu Gjevgjeli	54	44
3Burgu për fëmijë Ohër	27	4
GJITHSEJ	2083	2098

³ Të dhënat për kapacitetin e institucioneve ndëshkuese-korrektuese janë në përputhje me të dhënat që përmban Përgjigja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut pas Raportit të Komisionit për luftimin e torturës, trajtimin çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues (KPT) nga data 07 deri në 10 dhjetor të vitit 2020 (CPT / Inf (2021) 19). Mirëpo, gjatë vizitave është konstatuar se në disa nga institucionet kapacitetet reale akomoduese janë më të vogla se ato të përmendurat, si për shembull në Burgun Strumicë, ndërsa për ENK Shtip është marrë informacion se kapaciteti akomodues për të dënuarit është 210. Në tabelë nuk janë theksuar kapacitetet akomoduese të Seksionit të hapur të Burgut të Kumanovës në Kriva Pallankë, ndërkaq bëhet fjalë për kapacitet prej 23 personash.

ndërsa më shumë se pesëqind persona ose një e katërta e numrit të përgjithshëm të të dënuarve janë të vendosur në repartin e mbyllur dhe në seksionin e ashtuquajtur "ambulanca". Numri i të dënuarve që janë vendosur në disa krahë të këtyre seksioneve është dy herë më i madh krahas kapacitetit aktual. Gjatë vizitës u gjetën persona të dënuar të cilët flejnë në korridore, në dyshekë të improvizuar në dysheme, si dhe në krevate trekatëshe, ndërsa në disa dhoma të dënuarit janë detyruar të flejnë "me turne". Ekipi i MPN-së ka konstatuar se në një dhomë vendosen 16 të dënuar, kështu që për shembull në një dhomë prej 16,5m² me 8 shtretër janë vendosur 16 të dënuar, ndërsa në një dhomë tjetër prej 19m² janë vendosur 12 persona të dënuar. Në një numër të madh dhomash me kushte jo adekuate vendosen më shumë se 9 persona të dënuar.

Tabela nr.2

INK	Kapaciteti për personat e paraburgosur	Gjendje e hasur gjatë vizitës
Burgu Shkup	243	209
Burgu Kumanovë	50	28
Burgu Manastir	33	20
Burgu Gjevgjeli	12	8
Burgu Ohër	12	12
GJITHSEJ	350	277

Gjatë vizitave, ekipi i MPN-së konstatoi mbipopullim edhe në disa hapësira të seksioneve të paraburgimit në disa institucione ndëshkuese-korrektuese. Konkretisht, edhe pse kapaciteti i seksioneve të paraburgimit nuk ishte çdokund i plotësuar tërësisht, megjithatë u gjetën dhoma në të cilat nuk janë respektuar standardet minimale që parashikojnë 4m² për çdo person të dënuar kur janë të vendosur më shumë të dënuar në një hapësirë. Kështu, p.sh., në Burgun e Shkupit në një dhomë me sipërfaqe prej 9m² ishin vendosur 3 persona, në Burgun e Manastirit në një dhomë prej 20m² ishin vendosur 6 krevatë (në ditën e vizitës ishin vendosur 4 persona), në Burgun e Kumanovës në dhoma prej 15m² janë vendosur nga 4 persona.

Në pjesën e kushteve materiale⁴, ekipi i MPN-së konstatoi se pothuajse në secilin in-

⁴ Qeveria e Republikës së Maqedonisë për çdo vit miraton Program për financimin e ndërtimit, rikonstruimit, mirëmbajtjes së objekteve dhe pajisjes së institucioneve ndëshkuese dhe korrektuese. Në përputhje me programin për vitin 2021, ishte planifikuar të realizohen aktivitete investive me vlerë të përgjithshme prej 199.500.000,00 denarë, prej të cilave 148.800.000,00 denarë janë mjete nga kredia nga Banka për zhvillim të Këshillit të Evropës. Për punët ndërtimore dhe zejtare dhe blerjen e pajisjeve për nevojat e institucioneve ndëshkuese-korrektuese janë siguruar mjete me vlerë të përgjithshme prej 11.640.000,00 denarë

stitucion ndëshkues-korrektues janë bërë investime të caktuara në pjesën e përmirësimit të infrastrukturës, e cila është veçanërisht e dukshme në Burgun e Tetovës. Ndërsa, në disa institucione ndëshkuese-korrektuese është konstatuar se pjesët që janë rinovuar, për shkak të mirëmbajtjes joadekuate janë shkatërruar ose janë bërë jofunksionale, si për shembull disa nga hapësirat në Burgun e Strumicës dhe ENK Shtip. Në Burgun e Shkupit, disa hapësira të paraburgimit tashmë ishin mbyllur pas rekomandimeve të dërguara më parë nga Avokati i Popullit, ndërkaq edhe në ditën e vizitës u inspektuan disa dhoma që ishin në gjendje jashtëzakonisht të keqe materiale, me nivel të lartë të lagështisë dhe mykut në mure, të pajisura me shtretër dhe dyshekë të papërshtatshëm, me inventar të vjetër dhe të rrënuar, nivel të ulët të higjienës, nyje sanitare jofunksionale dhe çezma të prishura.

Ankesa për qasje deri te uji kishte edhe nga të dënuarit e Burgut të Kumanovës, i cili është vërejtur si problem që nga hapja e Burgut. Zyrtarët theksuan se janë ndërmarrë aktivitete për tejkalimin e këtij problemi, por në ditën e vizitës u konstatua se të dënuarit ende po mbushin, ruajnë dhe depozitojnë shishe plastike me ujë.

Mangësi më të mëdha në pjesën e kushteve materiale janë konstatuar në ENK Idrizovë. Në objektin/ndërtesën ku janë vendosur personat e dënuar me trajtim të mbyllur, ose i ashtuquajturit repart i mbyllur, për shkak të kushteve joadekuate materiale nuk vendosen në të ashtuquajturit Krahu i "dytë", "pestë" dhe "tetë", por ekipi i MPN-së-konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet për vendosje as në pjesën tjetër të kësaj ndërtese. Në këtë kuptim, ***kushtet në të cilat janë vendosur personat e dënuar në të ashtuquajturit Krahu "i tretë", "i katërt" dhe "i shtatë", njëlloj si në ndërtesën e të ashtuquajturit seksioni „ambulanca”, lirisht mund të përshkruhen si johumane dhe degraduese.*** Personat e dënuar të vendosur në këtë pjesë të Entit ndëshkues-korrektues u gjetën duke fjetur në sfungjerë në dysheme, në korridore, në krevatë metali të improvizuar të vendosur njëri mbi tjetrin në tre nivele. Ato nuk kanë vend ku të ruajnë sendet e tyre personale, prandaj i kanë lënë në çanta poshtë ndër ndonjë krevat, ose në dyshekët ku flejnë. Me përjashtim të disa dhomave, higjiena ishte në nivel jashtëzakonisht të ulët për faktin se në një dhomë vendosen një numër i madh personash. Dhomat janë plot me buburreca, pleshta dhe çimka. Në disa dhoma në ditën e vizitës është matur temperaturë nën 17°C dhe nivel i lagështisë mbi 60% (RH). Të dënuarit po ballafaqohen edhe me probleme me presionin dhe qasjen deri te uji. Në disa dhoma u gjetën fuçi me ujë për dush, i cili ngrohet në mënyrë të improvizuar me tela elektrike.

Një shkallë e lartë e rrezikut nga tortura dhe trajtimi tjetër jopërkatës ose ndëshkimi në institucionet ndëshkuese-korrektuese ka të bëjë edhe me informacionet e marra nga ekipi i MPN-së nga personat e dënuar dhe të paraburgosur gjatë bisedave që janë zhvilluar me ta në bazë konfidenciale dhe pa praninë e zyrtarëve. Në shumicën e institucioneve ndëshkuese-korrektuese janë pranuar ankesa për sjellje joadekuate në formë të trajtimit të ashpër, ofendues, stigmatizues dhe degradues nga ana e punonjësve, ndërsa në tre institucione ndëshkuese-korrektuese janë pranuar pretendime për frikësim dhe kërcënime, si dhe për maltretim fizik.

Në një prej institucioneve ndëshkuese-korrektuese u morën informacione se të dënuarit janë frikësuar dhe maltretuar që nga hyrja e tyre në institucion për veprën që e kanë kryer dhe për të cilën janë dërguar për vuajtje të dënimit me burg. Personat të cilët

theksuan pretendime konkrete se ata vetë ishin objekt të maltretimeve, frikësimeve dhe kërcënimeve nga ana e pjesëtarëve të policisë së burgut nuk donin dhe nuk praninin të përdoren të dhënat e tyre personale, as nuk ishin dakord që pretendimet e tyre të hetohen, duke u friguar se mund të identifikohen lehtë.

Personat u njoftuan se përfaqësuesit e ekipit të MPN-së këto pretendime mund t'i përcjellin tek Mekanizmi i Kontrollit Civil (njësi e posaçme në kuadër të AP-së), si dhe në Prokurorinë Publike kompetente për kryerjen e hetimeve zyrtare. Megjithatë, personat deklaruan se nuk do të donin hetime të mëtejshme lidhur me atë që na thanë. Njëri prej personave theksoi se që nga momenti i keqtrajtimit e deri më tani, tashmë "vetë ka menaxhuar situatën" dhe ka normalizuar marrëdhëniet me policinë e burgut, për çka edhe "nuk dëshiron të hapet çështja".

Në përgjithësi, të dënuarit që deklaruan se ishin keqtrajtuar, kishin frikë nga pasojat negative të cilat do të ndikonin në trajtimin e tyre nëse zbulohesh se kishin raportuar. Lidhur me këtë, u pranuan pretendime edhe se ka ndodhur të dënuar të tjerë, të cilët edhe pse ishin "të afërt" me policë të caktuar të burgut, t'i frikësojnë dhe kërcënojnë të dënuarit që donin të ankoheshin nga sjellja e policëve të burgut.

"Afërsia" e disa të dënuarve me policinë e burgjeve u theksua gjithashtu si një nga arsytet pse disa të dënuar deklaruan se janë të detyruar "të durojnë dhe të heshtin" për keqtrajtimet që iu bëhen nga ana e të dënuarve të tjerë, ndërkaq me dijeni dhe "leje" të disa policëve të burgjeve⁵. Lidhur me këtë, disa të dënuar deklaruan se nuk ndihen të sigurt dhe se "çdo ditë përpiqen të mbijetojnë", sidomos në ENK Idrizovë⁶.

Frika e të dënuarve për të denoncuar keqtrajtimin nga ana e policëve të burgjeve ose nga të dënuarit e tjerë, tregon një numër të errët të rasteve të padenoncuar për sjelljen jopërkatese nga personat zyrtarë dhe dhunën ndërmjet të dënuarve, që në disa institucione është dy herë më i lartë se numri zyrtar i rasteve të raportuara.

Siguria e të dënuarve dhe të paraburgosurve në mënyrë plotësuese vihet në pyetje edhe për shkak të numrit të pamjaftueshëm të personelit të burgjeve, veçanërisht të policisë së burgjeve. Ekipi i MPN-së arriti në përfundimin se edhe përkundër një numri punësimesh, problemi i mungesës së personelit është i përbashkët për pothuajse të gjitha institucionet ndëshkuese-korrektuese. Në disa prej institucioneve është konstatuar një situatë ku një polic i burgut është përgjegjës për mbikëqyrjen e më shumë se pesëdhjetë të dënuarve.

Gjatë vizitave në institucionet ndëshkuese-korrektuese, ekipi i MPN-së nuk ka vëre-

⁵ Gjatë bisedave me të dënuarit, janë marrë informacione se në rastet kur ata janë ankuar pranë policisë së burgjeve se janë keqtrajtuar nga të dënuarit e tjerë, si për shembull se janë rrahur, fyer, poshtëruar, se janë kërcënuar, janë keqtrajtuar nëse nuk bëjnë diçka që kërkohet prej tyre, se kanë qenë të detyruar të paguajnë për shtrat apo të flegjë në tokë, etj., nga ana e policëve të burgjeve kanë marrë përgjigje: "asgjë nuk ke, mos u anko", "dhe këtë e ke pak", "kjo është kjo" dhe përgjigje të ngjashme pa marrë asnjë masë për të mbrojtur personat që ankoheshin.

⁶ Në këtë drejtim, ekipi i MPN-së është udhëhequr nga Rregullorja evropiane kundër torturës, gjegjësisht ka pasur parasysh mjetet e renditura në Aneksin 2 të RREGULLORES (BE) 2019/125 TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT të datës 16 janar 2019, në lidhje me tregun me mallra të caktuara që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën ose trajtimin tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues ose ndëshkues..

jtur mjete që nuk kanë kurrfarë përdorimi praktik përveç për qëllime të dënimit me vdekje, torturës dhe trajtimit tjetër brutal, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkues⁷. Mirëpo, në ambientet e policisë së burgjeve në disa institucione ndëshkuese-korrektuese janë vërejtur doreza druri, si dhe këmbë hekuri të mbështjellura me lecka, shkop gome të pazakontë, si dhe shkop druri i ashtuquajtur shkop "bejsbolli", për të cilët nuk u morën informacione më të detajuara për arsyen se pse mbahen.



Ekipi i MPN-së inspektoi gjithashtu armët dhe mjetet e shtrëngimit në dispozicion të policisë së burgjeve dhe konstatoi se nuk kishte standarde kombëtare veçanërisht për llojin dhe karakteristikat e armëve, mjeteve dhe pajisjeve për përdorimin e të cilave është e autorizuar policia e burgjeve. Lidhur me këtë, u konstatua se policia e burgjeve në institucionet ndëshkuese-korrektuese disponon me lloje të ndryshme të shkopinjve prej gome, mjete për lidhje dhe armë e pajisje të tjera, për përdorimin e të cilave është e autorizuar.

Sa i përket mjeteve për lidhje, ekipi i MPN-së vërejti se policia e burgjeve disponon me lloje të ndryshme prangash metalike për duar, ndërsa në dy institucione ndëshkuese-

⁷ Në këtë drejtim, ekipi i MPN-së është udhëhequr nga Rregullorja evropiane kundër torturës, gjegjësisht ka pasur parasysh mjetet e renditura në Aneksin 2 të RREGULLORES (BE) 2019/125 TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT të datës 16 janar 2019, në lidhje me tregun me mallra të caktuara që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën ose trajtimin tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruës ose ndëshkues.

korrektuese disponojnë edhe me rripa të posaçëm lëkure për të cilët u theksua se përdoren për fiksimin e personave që vetëlëndohen.

Gjatë vizitave, nga ana e një numri të konsiderueshëm të të dënuarve dhe të paraburgosurve u theksuan pretendime se gjatë shoqërimit jashtë institucionit ku janë vendosur, gjatë kohës së transportimit i kanë lidhur me pranga në duar. Disa prej tyre u ankuan se ishin lidhur shumë fort, pa mbajtur llogari për qarkullimin normal të gjakut. Në këtë kuptim, ekipi i MPN-së në disa prej institucioneve ndëshkuese-korrektuese konstatoi se përdoren pranga "të prishura", të cilat nuk përthakohen në prerjen e fundit që hyn në mekanizmin për mbyllje. Disa persona deklaruan se kanë qenë të lidhur me pranga në duar pas shpine, ndërsa kishte disa raste ku theksuan se personat ishin lidhur me pranga për "shkopinjte" që gjenden afër karriges në automjetet për transport, duke theksuar të njëjtën si një ndjenjë të pakëndshme.

Përdorimi i mjeteve për lidhje gjatë transportimit të personave të dënuar është përcaktuar me urdhërat për përcjellje dhe në këto raste policia e burgjeve nuk përgatit raporte të veçanta për përdorimin e mjeteve për shtrëngim. Nga bisedat me komandantët e disa institucioneve ndëshkuese-korrektuese, u theksua se është duke u përgatitur një Rregullore e re e cila do të rregullojë më për së afërmi mënyrën e përdorimit të mjeteve shtrënguese nga ana e pjesëtarëve të policisë së burgjeve, ku do të theksohet ndalimi për lidhjen e prangave pas shpine ose për sende të tjera gjatë transportit dhe shoqërimit.

Nga bisedat e realizuara me pjesëtarët e policisë së burgut u morën informacione se në institucionet ndëshkuese-korrektuese nuk organizohen gjuajtje të rregullta me armë, dhe se nuk organizohen as trajnime/seminare për mënyrën e përdorimit të mjeteve të tjera për shtrëngim. Lidhur me këtë, nga ana e kuadrit drejtues të policisë së burgut në institucionet ndëshkuese-korrektuese u theksua se lloji i tillë i trajnimeve janë parashikuar në "Programin për trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm dhe testim të njohurive dhe aftësive të pjesëtarëve të personelit të burgut", i cili filloi me realizimin në fund të vitit 2021.

Gjatë vizitave të kryera, ekipi i MPN-së konstatoi se përdorimi i rripave të lëkurës (prangave) në institucionet ndëshkuese-korrektuese Burgu Shkup dhe ENK Idrizovë, në vazhdimësi për një periudhë prej shumë ditësh, në disa raste edhe 10 ditë, mund t'i nënshtrohet nocionit çnjerëzor dhe trajtimit degradues. **Fakti që kjo praktikë vazhdon edhe pas ndërhyrjeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, si dhe të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës në vitet 2006, 2007, 2008, 2019 dhe 2020, pikërisht për këtë punë, tregon qartë mungesën e një sistemi koherent të burgjeve që funksionon sipas rregullave të qarta të respektuara nga personeli profesional. Praktikrat e tilla çnjerëzore dhe degraduese duhet të ç'rrenjosen njëherë e përgjithmonë nga institucionet ndëshkuese-korrektuese.**

Kujdesi shëndetësor edhe mëtej mbetet një nga problemet më të mëdha në institucionet ndëshkuese-korrektuese. Në shtojcë të kësaj, është edhe fakti se pjesa më e madhe e parashtrësive të parashtruara zyrtarisht pranë zyrës së Avokatit të Popullit nga ana e personave të dënuar ka të bëjnë me mbrojtjen joadekuatë shëndetësore, e sidomos kur duhet të dërgohen për kontrolle specialistike dhe stomatologjike jashtë institucioneve. Në këtë drejtim, edhe ekipi i MPN-së konstatoi se shërbimi shëndetësor në institucionet ndëshkuese-korrektuese nuk është mjaft i organizuar për të mundësuar që kërkesat për konsultim me mjek të personave të dënuar dhe të paraburgosur të plotësohen pa vone-

sa të panevojshme. Paraqitja e nevojës për konsultim dhe kontroll nga mjeku në praktikë bëhet nëpërmjet pjesëtarëve të policisë së burgjeve dhe në disa prej institucioneve ndëshkuese-korrektuese u morën informacione se bëhet i ashtuquajtimi filtrimi i kërkesave mjekësore, gjegjësisht të njëjtat nuk i përcillen personelit mjekësor nga pjesëtarët e policisë së burgjeve. Sfidë serioze në institucionet ndëshkuese-korrektuese është kujdesi psikiatrik, gjegjësisht mungesa e tij, si dhe trajtimi joadekuat i personave me çrregullime të shkaktuara nga përdorimi i drogës. Ky i fundit është një problem serioz në Burgun e Kumanovës, ku ekipi i MPN-së realizoi dy vizita, njëra prej të cilave kishte për qëllim verifikimin e informatave për përmirësimin e trajtimit të personave me çrregullime, të marra nga Ministria e shëndetësisë. Fatkeqësisht, u konstatua se nuk kishte ndonjë përmirësim të dukshëm dhe se personat që deklarorin se kishin probleme me varësinë ndaj drogës nuk kishin mundësi të trajtoheshin me terapi zëvendësuese, përveç nëse kjo ishte bërë para pranimit të tyre në Burg. Përmirësimi i mbrojtjes shëndetësore dhe përmbushja e objektivave të përcaktuara në këtë pjesë të Strategjisë Kombëtare duhet të jetë prioritet i Ministrisë së shëndetësisë së bashku me Ministrinë e drejtësisë, si një nga komponentët kyç të reformave që AP-MPN i konsideron të nevojshme për funksionimin në mënyrë të drejtë të sistemit të burgjeve.

Gjatë vizitave, ekipi i MPN-së ka konstatuar mungesë të kapaciteteve për realizimin e aktiviteteve të parapara trajtuese për personat e dënuar, që synojnë për realizimin e qëllimeve të ndëshkimit – resocializimin dhe përshtatjen sociale. Përkatësisht, Udhëzimi për përcaktimin e llojeve dhe mënyrave të trajtimit të personave të dënuar⁸, parasheh masa të përgjithshme trajtuese⁹, si dhe programe specifike¹⁰ për disa kategori të personave të dënuar. Megjithatë, ekziston zbrastirë e madhe mes aktiviteteve të parapara në dokumentet e miratuara dhe aktivitetet trajtuese që realizohen në praktikë. Mungesa e kapaciteteve për përmirësimin e gjendjeve në pjesën e resocializimit në entet ndëshkuese-korrektuese në masë të madhe është për shkak të mungesës së vullnetit të mirëfilltë të autoriteteve kompetente për zgjidhje permanente të këtij problemi, duke pasur parasysh se zvarritet me vite. Njëkohësisht, kjo ndikon edhe në mundësinë e rritjes së nivelit të rrezikshmërisë që sjellja ndaj personave të dënuar të karakterizohet si jonjerëzore dhe degraduese. Ky është shembull konkret i enteve tek të cilët është konstatuar mbipopullim në hapësira. Mbiipopullimi dhe kushtet materiale joadekuate nga njëra anë si dhe nga ana tjetër mungesa e aktiviteteve ditore, në mënyrë të drejtpërdrejtë kontribuon në tension

⁸ I sjellur nga Ministri i drejtësisë me datë 22.05.2020 (Gazeta zyrtare nr.133/2020).

⁹ 1.Puna e personave të dënuar; 2.Edukimi i personave të dënuar; 3.Edukim i personave të dënuar sipas profesionit; 4.Edukim moral-etik dhe vetorganizim i të dënuarve; 5.Aktivitete të lira, sport dhe rekreacion i personave të dënuar.

¹⁰ Trajtimi i personave të dënuar të cilët keqpërdorin droga dhe substanca tjera psikotrope; -trajtimi i personave të dënuar të cilët janë keqpërdorues të alkoolit;- trajtimi i personave të dënuar të cilët janë kryerës të delikteve seksuale; -trajtimi i personave të dhunshëm në burg;- trajtimi i personave të dënuar për vepra penale me elemente të dhunës;- trajtimi i personave të mitur të dënuar;- trajtimi i fëmijëve;- trajtimi i femrave të dënuara;- trajtimi i personave të dënuar me shumë vite dhe me burgim të përjetshëm;- trajtimi i personave të dënuar të radikalizuar;- trajtimi i personave të dënuar me rrezik dhe rrezik shumë të lartë të sigurisë dhe trajtimi mjekësor dhe psikologjik i personave të dënuar (për kohë të caktuar apo gjatë tërë kohës së vuajtjes së dënimit).

imin e atmosferës mes personave të dënuar të cilët vazhdimisht janë së bashku, si dhe në sjelljen e tyre me personat zyrtar.

Mungesa e aktiviteteve dhe mundësisë që një pjesë të konsiderueshme të ditës t'a kalojnë jashtë hapësirave në të cilat janë akomoduar, posaçërisht është e shprehur në seksionet e paraburgimit të burgjeve. Personat e paraburgosur kalojnë 22 orë në ditë në hapësirat e tyre, madje disa prej tyre gjatë bisedave shfrytëzojnë shprehjen "ditë-vit" për të përshkruar se si ju kalon dita të mbyllur vazhdimisht mes katër mureve.

Në pjesën e korrupsionit, ekipi i MPN-së ka konstatuar se edhe përkundër aktiviteteve të ndërmarra nga autoritet e burgut, perceptioni dhe pohimet e personave të dënuar synojnë faktin se ky vazhdon të jetë problem aktual në disa ente ndëshkuese – korrektuese. Në këtë kuptim, janë marrë të dhëna se futja e mjeteve të ndaluara në shumicën e rasteve kryhet me ndërmjetësim të personave zyrtarë, ndërsa gjithashtu edhe zhvendosja nga një institucion në tjetër institucion ndëshkues – korrektues ose në hapësira tjera brenda institucionit të njëjtë me kushte më të mira shpesh për "shërbimin" e tillë duhet paguar një shumë të caktuar të hollash.

Ekipi i MPN-së gjatë vizitave iu kushtoi rëndësi edhe masave të shqiptuara disiplinore ndaj personave të dënuar. Në këtë kuptim, është konstatuar se prej gjithsej 1110 sanksioneve të shqiptuara disiplinore, në 9 ente ndëshkuese-korrektuese¹¹, në 617 raste ose 55,5% ishte shqiptuar ndëshkim disiplinor – izolim prej 3 deri në 14 ditë.

Nga aspekti formal-juridik është konstatuar se në shumicën e enteve ndëshkuese-korrektuese procedura e shqiptimit të masës disiplinore udhëhiqet në pajtim me "Rregulloren për mënyrën e veprimit të komisionit disiplinor gjatë udhëheqjes së procedurës kundër personave të dënuar"¹², me disa përjashtime ku është vërejtur se në disa ente ndëshkuese-korrektuese nuk respektohen plotësisht dispozitat në pjesën e udhëheqjes së debatit disiplinor, ndërsa nga personat e dënuar është kërkuar vetëm se të parashtrorjnë deklaratë me shkrim ku do t'i shënojnë pohimet e tyre në lidhje me akuzat për shkeljet e kryera disiplinore. Rregullorja parasheh mundësi edhe për ankimim të aktvendimit me të cilin është shqiptuar ndëshkimi disiplinor, përmes drejtorit të entit deri tek drejtori i DES-it, ndërsa konform Ligjit për konteste administrative është e paraparë mundësi që kundër vendimit të drejtorit të DES-it, personi i dënuar të parashtrorjë edhe padi deri tek gjykata administrative. Megjithatë, në praktikë ankesat kundër vendimeve të drejtorëve për ndëshkimet e shqiptuara disiplinore janë shumë të rralla, ndërsa padi deri tek gjykata administrative fare nuk janë parashtruar. Rregullorja përmban dispozita për mbrojtje të të drejtave të personave të dënuar, si dhe dispozita për të drejtën e personit të dënuar për të dhënë fakte dhe dëshmi dhe të drejtën e përkthyesit gjatë procedurës disiplinore, por nuk përmban dispozita të posaçme në pjesën e ndihmës juridike dhe faktikisht në entet ndëshkuese korrektuese as që ka sistem për ndihmë juridike për personat e dënuar si një prej garancive se të drejtat e tyre gjatë procedurës do të respektohen plotësisht dhe se personat e dënuar do të kenë mundësi reale që t'i ankimojnë vendimet tek drejtori i DES

¹¹ Ekipi i MPN-së nuk ka të dhëna për ndëshkimet e shqiptuara disiplinore vetëm për INK Shtip.

¹² I sjellur nga ana e drejtorit të DES, në qershor të vitit 2020.

ose të parashtrajnë padi tek gjykata administrative.

Në lidhje me ekzekutimin e masës disiplinore – izolim nga 3 deri në 14 ditë, është konstatuar se tek asnjë ent ndëshkues-korrektues nuk rrespektohet dispozita e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ku është paraparë se “personin e ndëshkuar çdo ditë e viziton mjek, ndërsa drejtori i institucionit njëherë në javë”. Në numrin më të madh të institucioneve ndëshkuese-korrektuese në pjesën e kushteve materiale nuk respektohen as standardet nacionale, të cilët parashohin: “*Hapësira në të cilën kryhet ndëshkimi disiplinor izolim patjetër duhet të jetë më së paku 9m 3/4m², gjatë ditës të jetë e ndriçuar, të ketë tualet, ujë të pijshëm, shtrat me mbulojë, tavolinë dhe karrige dhe të jetë e ngrohur*”.¹³

3.1. SHTËPIA EDUKUESE - PËRMIRËSUESE TETOVË

Ekipi i MPN-së, vizitën e Shtëpisë edukuese përmirësuese (SHEP) Tetovë e realizoi pa paralajmërim më datë 21 dhjetor të vitit 2021, në bashkëpunim me d-r. Silvana Markovska – Simovska, specialist i psikiatrisë së fëmijëve dhe adoleshentëve, m-r. Ivo Kunoski, specialist i psikologjisë mjekësore, m-r. Aleksandra Coneva, punëtor i diplomuar social dhe prof.d-r. Blertha Ahmedi Arifi, docent në Fakultetin Juridik – Universiteti i Europës Juglindore.

SHEP Tetovë është vendosur në kompleksin e ri të mbyllur i cili ka për synim shqiptimin e masës edukuese – udhëzim në Shtëpinë edukuese përmirësuese, që është në pajtim me standardet ndërkombëtare të cilat parashohin se „*Të miturit nuk do të mbahen në institucione për të rritur, por në institucione të dizajnuara posaçërisht për ata*.”¹⁴

Në SHEP Tetovë akomodohen vetëm meshkuj, ndërsa fëmijët e gjinisë femërore të cilëve me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor ju është shqiptuar masa edukuese e udhëzimit për në Shtëpinë edukuese-përmirësuese akomodohen në Shtëpinë edukuese-përmirësuese për femra që gjendet në Institucionin ndëshkues-korrektues (INK) Idrizovë. Ata janë të akomoduar në seksionin për femra, ku mes tjerave, akomodohen edhe femra të dënuara me aktgjykim të plotëfuqishëm me burgim pavarësisht lartësisë së dënimit.¹⁵

SHEP Tetovë gjendet në afërsi të fshatit Volkovijë, në lartësi mbidetare prej rreth 560 metrave, 20-30 kilometra larg Tetovës, ndërsa rreth 12 kilometra nga Gostivari. Deri tek

¹³ Neni 236 par.2 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.99/2019 dhe 220/2019).

¹⁴ European Rules for juvenile offenders subject to sanctions or measures, Adopted by the Committee of Ministers on 5 November 2008 at the 1040th meeting of the Ministers’ Deputies, në të njejtin drejtim janë edhe rekomandimet e Komitetit Europian për parandalim të torturës: „Juveniles deprived of their liberty under criminal legislation“ -Extract from the 24th General Report of the CPT, published in 2015; Termi “të mitur” në këtë raport shfrytëzohet si përkthim i termit ang. „juvenile“, edhe pse si term juridik në legjislacionin maqedonas pozitiv- juridik është zëvendësuar me termin “fëmijë”.

Shtëpia edukuese-përmirësuese ka rrugë të asfaltuar, por nuk ka transport publik të zhvilluar mirë. Përkatësisht, ishte përmendur linja e autobusave e cila nuk transporton çdo ditë.

Në këtë kuptim, sipas ekipit të MPN-së është e patjetërsueshme të ndërmerren masa që do të përmirësojnë qasjen deri tek Shtëpia edukuese përmirësuese dhe do t'i lehtësojnë kontaktet e fëmijëve me familjet e tyre. Njëkohësisht, është theksuar nevoja e ndërmarrjes së masave plotësuese me të cilat do të nxiten aktivitete për integrimin e fëmijëve në rrethin kulturor, ekonomik dhe social të shoqërisë.¹⁶

Kapaciteti shtëpisë është për 110 fëmijë, ndërsa në ditën e vizitës ishin akomoduar 19 fëmijë. Nëse merren parasysh standardet europiane dhe tendencat moderne të cilat i referohen përparësive të institucioneve me kapacitete të vogla akomodimi, si dhe numrit mesatar të deritanishëm të fëmijëve të cilët kanë qenë të akomoduar në shtëpitë edukuese-përmirësuese tek ne, mandej mbetet e hapur pyetja se vallë me të vërtetë ishte i patjetërsueshëm ndërtimi i shtëpisë edukuese-përmirësuese me kapacitet për 110 fëmijë, në kushte kur gjithnjë e më shumë iu referohen alternativave të vuajtjes së dënimit në raste kur bëhet fjalë për fëmijë¹⁷.

Në pjesën më të madhe kushtet materiale i plotësojnë standardet e parapara, ndërsa duke pasur parasysh se bëhet fjalë për objekt i cili funksionon më pak se dy vite, mjetet dhe inventari janë të reja dhe të ruajtura.

Përkatësisht, çdo fëmijë ka shtrat të vetin, të pajisur me mbuloje të pastër. Në çdo dhomë ka dollap të posaçëm për gjërat personale, televizion, tavolinë pune dhe karrige. Në të gjitha dhomat ka hapësira në të cilat depërton dritë e mjaftueshme e dritës gjatë ditës, ndërsa gjithashtu çdo dhomë ka edhe tualet të vetin. Në ditën e vizitës është konstatuar se higjiena nëpër të gjitha hapësirat ishte në nivelin e duhur, ndërsa sipas informatave të fituara çdo fëmijë ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e të njëjtës, secili në dhomën e vet. Për hapësirat e përbashkëta ka orare të posaçme të kujdestarisë. Ekipi i MPN-së ka konstatuar se në institucion mbahet llogari për higjienën dhe për vetë faktin që ka (check) lista të posaçme për verifikim vizuel të pastërtisë dhe gjendjes së inventarit.

Gjatë vizitës është potencuar se fëmijët në çdo kohë mund të vizitohen nga prindërit e tyre dhe nga anëtarët e tjerë të familjes më të ngushtë, si dhe (me leje të drejtorit) edhe

¹⁵ „Aktvendim për shpërndarjen e personave të dënuar dhe fëmijëve në institucionet ndëshkuese – korrektuese dhe edukativo – korrektuese, si dhe personave të paraburgosur në seksionet e paraburgimit në institucionet ndëshkuese – korrektuese”, Gazeta zyrtare nr.10/2020, data e publikimit të Gazetës zyrtare: 16.01.2020.

¹⁶ Në përputhje me rregullat Europiane për kundërvajtës të mitur të cilët janë lëndë e sanksioneve ose masave, që parashohin se institucionet për të mitur duhet të jenë të vendosur në vende që kanë qasje të lehtë dhe që e lehtësojnë kontaktin mes të miturve dhe familjeve të tyre. Ato duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që do ta lehtësojnë integrimin në rrethin social, ekonomik dhe kulturor të bashkësisë..

¹⁷ Komiteti European për parandalim të torturës, gjithashtu në këtë kuptim si shembull pozitiv i përmend institucionet për të mitur të cilët mbështeten në konceptin e njësisve të vogla akomoduese me ekipe të ekipuara mirë, ku secila përbëhet nga një numër i kufizuar i dhomave njështratëshe (zakonisht jo më shumë se dhjetë), si dhe hapsirës së përbashkët.

nga persona tjerë. Në këtë kuptim, nga ana e të punësuarve u pohua se drejtori në më shumë raste kanë iniciuar dhe ndihmuar në organizimin e këtyre vizitave. Megjithatë, disa fëmijë theksuan se shpesh të afërmit e tyre nuk mund të vijnë "meqënëse ajo kushton" duke aluduar në harxhimet e udhëtimit, ndërsa u morën informacione edhe për disa fëmijë të cilët askush nuk i viziton.

Korrespondenca me prindërit dhe familjarët është pa kufizime edhe pse nuk praktikohet shumë shpesh. Në lidhje me kontaktet telefonike, është potencuar se fëmijëve ju lejohet dy herë në javë dhe sipas nevojës në raste të caktuara, por edhe vet ata potencuan se ajo nuk është e mjaftueshme dhe se kanë nevojë për leje për kontakte më të shpeshta telefonike me të afërmit e tyre.

Në këtë kuptim edhe ekipi i MPN-së konsideron se është e nevojshme që të bëhet vlerësim në suaza të shtëpisë edukuese – përmirësuese për nevojën e mundësisit të kontakteve më të shpeshta telefonike të fëmijëve me të afërmit e tyre. Faktikisht edhe standardet ndërkombëtare i referohen kontakteve të shpeshta telefonike me familjen dhe të afërmit, si dhe formave tjera të komunikimit me botën e jashtme. Nga këtu, ekipi i MPN-së e inkurajon Shtëpinë të rrisë zbatimin e teknologjive të reja informative gjatë komunikimit të fëmijëve me të afërmit e tyre nëpërmjet vendosjes në disponim të mjeteve dhe mundësisit të video thirrjeve.

Standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni vendas parasheh që çdo fëmijë në moshën e shkollimit të obligueshëm ka të drejtë shkollimi që i përgjigjet nevojave dhe aftësive të tij/sajja dhe i cili është i dizajnuar për ta përgatitur për rikthim në shoqëri. Megjithatë, ekipi i MPN-së gjatë vizitës konstatoi se asnjë prej fëmijëve të akomoduar në Shtëpinë edukuese-përmirësuese nuk viziton arsim formal. Ishin marrë të dhëna se me përkrahje të UNDP-së janë angazhuar arsimtarë nga shkolla e fshatit fqinjë të cilët iu mbanin orë fëmijëve nga lënda e maqedonishtes, matematikës dhe anglishtes. Fëmijët ishin ndarë në dy grupe, konform nivelit të arsimit. Projekti i këtillë kishte zgjatur deri në gusht të vitit 2021 dhe që atëherë procesi arsimor ishte ndërprerë plotësisht.

Gjatë vizitës nga ana e personave zyrtarë që ishin udhëheqës jemi informuar se në suaza të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës përgatitej program e posaçme dhe se procesi arsimor pritet të funksionojë përsëri në fillim të vitit 2022.

Gjatë vizitës ishte konstatuar se në periudhë prej datës 01.01. e deri më 21.12.2021, janë realizuar gjithsej 34 procedura disiplinore, prej të cilave 11 herë janë sjellur aktvendime me të cilat ka qenë e shqiptuar masa e referimit për në dhomë të veçantë në kohëzgjatje prej 7 ditëve, 6 herë në kohëzgjatje prej 5 ditëve dhe 8 herë referimi në dhomë të posaçme ka qenë i shtyrë me kusht. Në 2 procedura është vendosur që të shqiptohet masa edukuese - kufizim i komoditeteve në kohëzgjatje prej 3 muajve, 2 herë ka qenë e shqiptuar vërejtje publike, ndërsa 4 herë vetëm vërejtje dhe në 1 procedurë fëmija ka qenë i liruar nga përgjegjësia.

Këto 34 procedura në të cilat është vendosur me aktvendim janë bërë si shkak i shkeljeve të kryera nga ana e 14 fëmijëve. Më së shumti procedurat që janë udhëhequr kundër një fëmije janë 6, ndërsa kundër shumë fëmijëve tjerë janë bërë nga 4 apo 5 procedura.

Në këtë kuptim, nëse merret parasysh shkalla e përsëritjes së shkeljeve disiplinore ose shqiptimi i masës së referimit në dhomë të posaçme, atëherë ndoshta imponohet edhe nevoja e përkushtimit më të madh të vëmendjes gjatë konfirmimit të aktiviteteve të posaçme korektuese që ekipi profesional duhet t'i ndërmarrë kundër fëmijës për kohëzgjatjen e ndarjes në dhomë të posaçme, përkatësisht gjatë përgatitjes së programit të posaçëm për trajtim të përforcuar, që konform Udhëzimit është i paraparë që të përgatitet në kolegiumin arsimor.

Sipas llojit të shkeljeve të kryera disiplinore për të cilat janë ngritur procedura disiplinore, numri më i madh i tyre ka të bëjë për "sulm fizik të fëmijës", ose gjithsej 9 prej tyre, ndërsa 7 janë për moszbatimin e urdhërit të personit zyrtar, 6 janë për shkak të hyrjes ose përpunimit të lëndëve që mund të përdoren për sulm ose lëndim, 4 për shkak të rrezikimit të shëndetit të vet me vetëlëndim, 3 për shkak të kryerjes së dëmit më të madh material dhe nga 1 për tentim për arratisje dhe shkelje të rregullave për mbrojtje nga zjarri.

Nga bisedat e bëra me personelin dhe fëmijët e akomoduar në institucion, janë marrë të dhëna se sulmet fizike si shkelje më të përfaqësuara disiplinore për të cilat janë udhëhequr procedura nuk kanë rezultuar me lëndime të rënda trupore. Megjithatë, ekipi i MPN-së e theksoi obligimin e të punësuarve dhe personave zyrtarë që të zhvillojnë qasje dinamike që do ta garantojë sigurinë e çdo fëmije. Kujdes i veçantë është i patjetërsueshëm që t'i kushtohet mbrojtjes së të miturve të dobët dhe pengimit të viktimizimit të tyre.

Ekipi i MPN-së, gjithashtu në mënyrë të veçantë potencon se administrata e shtëpisë ka përgjegjësi që të ndërmarrë masa të posaçme të kujdesit për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e keqpërdorimit, duke përfshirë edhe shqetësimet seksuale apo ndonjë lloj tjetër shqetësimi. Anëtarët e personelit duhet të kenë kujdes për shenjat e maltretim (duke përfshirë sulm fizik dhe seksual, keqpërdorim verbal, zhvatje dhe vjedhje të gjësendeve tjera materiale të të miturve) dhe duhet të dijnë se si të reagojnë në mënyrë adekuate dhe të miratojnë qëndrim proaktiv për të penguar incidentet e tilla.

Gjatë vizitës, ekipi i MPN-së nga inspektimi në evidencën për përdorimin e mjeteve të shtrëngimit vërejtë se në të njëjtën nuk është regjistruar asnjë rast, ndërsa gjithashtu edhe personat zyrtar potencuan se në shtëpi nuk përdoret dhuna, as mjetet e shtrëngimit ndaj fëmijëve të cilët janë duke vuajtur masën disiplinore - referim në Shtëpinë edukuese - përmirësuese. Në anën tjetër, nga bisedat e bëra me fëmijët janë marrë informacione se ka pasur raste kur janë goditur me shkopinj prej druri ose madje me "shuplaka edukuese". Përkatësisht, metodat e këtilla "edukuese" janë zbatuar prej disa të punësuarve në situata kur kanë intervnuar gjatë përleshjes fizike ose grindjes verbale para se të eskalojë, si dhe për shkak të mosrespektimit të urdhëresave ose sjelljes së pahijshme dhe të pafytyrë ndaj personave zyrtarë. Sipas shumicës të cilët i theksuan këto metoda "edukuese", të njëjtit nuk kanë vepruar për qëllim të lëndimit fizik apo shkakimit të dhimbjes serioze, por shumica kanë synuar manifestimin e forcës dhe autoritetit për sjelljen e pahijshme.

Gjatë vizitës nuk ishin vërejtur asnjëlloj lëndë apo mjeti që shfrytëzohen për maltretim apo ndonjë lloj tjetër të veprimit mizor, johuman apo nënçmues, ndëshkues ose poshtërues mirëpo në një prej hapsirave zyrtare janë vërejtur shkopinj prej druri të cilët

mund të shfrytëzohen konform pohimeve të marra për sanksionim "edukativ".

Në këtë kuptim, ekipi i MPN-së rekomandon që të ndërmerren masa për inkurajimin e fëmijëve që të paraqesin raste eventuale të maltretimit ose vepërimit jo adekuat nga ana e personave zyrtarë përmes bërjes të qartë atyre se do të mbrohen dhe nuk do të vuajnë asnjë pasojë të dëmshme për shkak të paraqitjes së dorëzuar.

Ekipi i MPN-së gjithashtu rekomandon që menjëherë të ndërprehet çfarëdo lloj sanksionimi që mund të ndikojë në mënyrë nënçmuese dhe degraduese ndaj fëmijëve të akomoduar në shtëpi, si dhe joshja e përdorimit të forcës dhe mjeteve të detyrimit, e cila do të jetë e përcjellur me vlerësimin e justifikimit për të njëjtën.

Ekipi i MPN-së gjatë vizitës mori informacione se çdo fëmijë ka sigurim shëndetësor dhe se të gjitha harxhimet që kanë të bëjnë me mjekimin e fëmijëve dhe përmirësimin e shëndetit të tyre mbulohen nga ana e Shtëpisë. Harxhimet për furnizimin e barërave gjithashtu mbulohen plotësisht nga ana e Shtëpisë, ndërsa gjatë inspektimit në ambulancë është vërejtur se disa pako me barëra janë me afat të skaduar, me ç'rast është rekomanduar që të njëjtit menjëherë të largohen dhe në të ardhmen të kenë kujdes për të njëjtën.

Personeli profesional i shtëpisë që kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve është i përbërë nga një motër medicinale, një psikolog, një pedagog dhe një punëtor social të cilët janë në dispozicion çdo ditë. Mjeku i përgjithshëm është prezent njëher në javë dhe në mënyrë plotësuese sipas nevojës, ndërsa në dispozicion është edhe stomatologu për kujdes themelor në ordinancën e pajisur të shtëpisë. Në bashkëpunim me Qendrën Klinike Tetovë, fëmijët kanë në dispozicion kujdes psikiatrik sipas nevojës. Përkatësisht, të gjithë fëmijët kanë mjek amë në Shtëpinë e shëndetit Tetovë dhe psikiatër amë në Qendrën Klinike Tetovë.

Gjatë vizitës, gjithashtu është konstatuar se diagnoza psikiatrike janë vendosur tek 58% e fëmijëve në shtëpinë edukuese - përmirësuese. Diagnoza më shpesh të vendosura sipas Klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve (MKB - 10) janë F91 (Çrregullim i sjelljes) dhe rrjedhimisht F41.2 (Çrregullim i përzier i ankthit - depresionit), F92 (Çrregullim i përzier i sjelljes dhe emocioneve), F44.4 (Çrregullim disociativ motorik). Gjendjet më të shpeshta komorbide janë këto diagnoza: F51 (Çrregullim joorganik i të fjeturit), F65.2 (Egzibicionizëm), F64.8 (Çrregullime tjera të identitetit gjinor), F60.3 (Personalitet emocional jostabil), G44 (Sindrome tjera të kokëdhimbjes).

Shërbimet profesionale fëmijët i pranojnë në institucionet shëndetësore jashtë shtëpisë, ndërsa atje janë të shoqëruar nga policia e burgut, që ndikon, respektivisht e kufizon ndjenjën e sigurisë dhe besueshmërisë gjatë bisedës me psikiatrin. Kontrollimet e gjendjes mendore dhe efektet e barërave, për shkak të faktit se duhet të transportohen tek institucionet shëndetësore, nuk janë aq të shpeshta. Disa fëmijë shkojnë më shpesh në kontrollë, për shkak të përkeqësimit të gjendjes, ndërsa ata që nuk ankohen për vështirësi paraqiten për kontrollë edhe pas disa muajve. Në kuadër të kësaj është me rëndësi të përmendet se kontrollën mjekësore e kryen specialist psikiatër, dhe jo psikiatër i fëmijëve apo adoleshentëve dhe me atë paraqitet rreziku i trajtimit sikurse i individëve

të rritur edhe në lidhje me barërat edhe dozat, edhe pse shkencëtarisht është vërtetuar se pjekuria e trurit nuk është deri në moshën 18 vjeçare, por deri në moshën 24 vjeçare të jetës.

Në lidhje me trajtimin farmakologjik është konstatuar se me terapi antipsikotike me Risperidone janë tre fëmijë, me Nozinan (Levomepromazine) janë gjashtë fëmijë, me Olanzapine janë tre fëmijë dhe me Prazine është një fëmijë. Disa fëmijë njëkohësisht trajtohen me dy lloj barëra antipsikotike, ndërsa një fëmijë i është përshkruar terapia para disa muajve me dy antipsikotikë dhe të tretin sipas nevojës, të gjitha këto jipen në të njëjtën kohë. Nga terapia anksiolitike, gjashtë fëmijë janë në terapi me Helex (Alprazolm), nëntë fëmijë janë me Diazepam, tre fëmijë me Flurazepam dhe një me Prazepam. Disa prej tyre marrin nga dy prej këtyre barërave. Nga terapia antidepresive, tre fëmijë janë me Sertraline, dy janë me Paroxetine dhe dy me Escitalopram. Nga hipnotikët, madje tetë fëmijë pranojnë Sanval, përkatësisht Zolpidem si terapi për pagjumësi. Nga Psikostabilizatorët, vetëm një fëmijë është në terapi me acid valproik, përkatësisht Depakine. Asnjë fëmijë që edukohet nuk është vendosur në terapi me psikostimulans, duke pasur parasysh faktin se në vendin tonë nuk është regjistruar asnjë ilaç psikostimulativë ose anti-ADHD dhe për shkak të kësaj këto barëra nuk janë në dispozicion as në këto institucione.

Për shkak të efekteve potencialisht të dëmshme nga trajtimi psikofarmakologjik i kësaj popullate, përdorimi i barërave psikiatrike duhet të kufizohet për gjendjet për të cilat janë krijuar, përkatësisht për trajtim të çrregullimeve serioze mendore. Rritja e përdorimit e barërave psikofarmakologjike jo vetëm që mund të jetë zgjidhje e gabuar për shkak të veprimit të tyre ndaj zhvillimit të trurit, por ajo gjithashtu mund të pengojë përpjekjet për rehabilitimin e këtyre individëve të rinj. Qasja e këtyre rrallë mundëson zgjidhje konstruktive të problemeve të tyre për të zhvilluar aftësi jetësore adekuate dhe përsëri të mund të reintegrohen në shoqëri.

Në këtë kuptim, AP-MPN rekomandon që barërat psikotropike të shfrytëzohen me kujdes të shtuar dhe vetëm pas vlerësimit të rreziqeve potenciale, përfitimeve, efekteve negative dhe alternativave tek të rinjtë. Nëse shfrytëzohen barëra psikotrope, mjekët duhet të zbatojnë plan të zhvilluar individual dhe gjithëpërfshirës për trajtim të shëndetit mendor i cili përfshin pajtim, përputhshmëri dhe pjesëmarrje aktive të të rinjëve, si dhe modalitete të terapisë individuale, grupe dhe familjare dhe intervenime tjera adekuate të trajtimit. Trajtimi efektiv dhe menaxhimi me barëra psikotrope në fillim kërkon identifikim të vëmendshëm të simptomave të synuara, përcjellje të përgjigjes nga trajtimi dhe skringing të rregullt të efekteve negative.

Konstatimet dhe rekomandimet e përgjithshme nga vizitat e kryera në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese

Gjendje të konstatuara

- Shkallë e lartë e rrezikut nga tortura dhe veprimi tjetër jopërkatës në institucionet ndëshkuese-korrektuese;
- Frikë nga pasojat negative të personat e paraburgosur dhe të dënuar për paraqitjen e rasteve të torturës, keqtrajtimit dhe sjelljeve të tjera jopërkatëse nga personeli i burgut;
- Shkarkimi dhe emërimi i drejtorëve të burgjeve dhe zëvendësve të tyre nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk kryhet në bazë të kompetencës dhe aftësisë së tyre për ushtrimin e funksionit;
- Mbipopullimi në institucionet ndëshkuese-korrektuese është sërish një problem aktual;
- Kushtet në të cilat janë vendosur shumica e të dënuarve në ENK Idrizovë, në të ashtuquajturin Seksion i "mbyllur" dhe "ambulancor" janë johumane dhe degraduese;
- Numër i pamjaftueshëm i personelit të burgjeve, veçanërisht i punonjësve të policisë së burgjeve, për shkak të të cilit nuk mund të garantohet në mënyrë adekuate siguria e të dënuarve dhe e të paraburgosurve;
- Kujdesi shëndetësor edhe mëtej mbetet një nga problemet kryesore në institucionet ndëshkuese-korrektuese;
- Mungesë e kapaciteteve për realizimin e aktiviteteve të parapara për trajtimin e të dënuarve, me qëllim arritjen e qëllimeve të dënimit - risocializim dhe adaptim social.
- Akomodim jo adekuat dhe mungesë e trajtimit të duhur për edukimin, riedukimin, socializimin dhe risocializimin e fëmijëve të gjinisë femrore të cilave me vendim të plotfuqishëm u është shqiptuar masa edukative për dërgim në ent edukues-korrektues, ndërkaq masën e vuajne në pjesën e femrave të ENK Idrizovë ;
- Mungesë e procesit të rregullt formal-arsimor për fëmijët në entet edukuese-korrektuese;
- Kontrollë psikiatrike joadekuate të fëmijëve në Entin edukues-korrektues Tetovë (nuk janë kontrolluar nga ana e psikiatrit të specializuar për psikiatri të fëmijëve dhe adoleshentëve), rreziku për t'u trajtuar si të rritur në lidhje me barërat dhe dozat.

Rekomandime për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara

- DES të marrë masa shtesë me të cilat do të zvogëlohet rreziku nga tortura dhe veprimi tjetër joadekuat ndaj personave të dënuar përmes një mbikëqyrjeje të forcuar profesionale dhe inspektimit të drejtpërdrejtë në funksionimin e institucioneve ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese, si dhe inkurajimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar të paraqesin rastet e torturës dhe veprimeve të tjera jopërkatese nga ana e personelit të burgut;
- Respektimi i rregullave evropiane dhe rregullores kombëtare gjatë emërimit të drejtorëve dhe zëvendësve të tyre në institucionet ndëshkuese-korrektuese duhet të jetë imperativ për çdo qeveri. Çdo institucion ndëshkues-korrektues duhet të ketë një drejtor profesionist, të kualifikuar në mënyrë përkatese, jopolitik, i cili është zgjedhur me kujdes për shkak të përshtatshmërisë dhe integritetit të tij për të kryer atë që është një nga detyrat më komplekse në shërbimin publik;
- Qasje sistemore në përbaljen me mbipopullimin në institucionet ndëshkuese-korrektuese, përmes vendosjes së dialogut të vazhdueshëm, mirëkuptimit të ndërsjellë dhe veprimit të autoriteteve kompetente, drejtuesve të Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve dhe institucioneve ndëshkuese-korrektuese, ligjvënësve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe të gjithë faktorëve të tjerë aktivë;
- Renovimi i objekteve ekzistuese dhe fillimi i aktiviteteve për ndërtimin e objekteve të reja akomoduese për të dënuarit në seksionin e mbyllur të INK-ENK Idrizovë medoemos duhet të jetë prioriteti i Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve dhe autoriteteve kompetente;
- Autoritetet e burgut medoemos duhet të garantojnë sigurinë e përgjithshme dhe sigurinë personale të çdo të dënuari, për çka është e nevojshme DES në koordinim me udhëheqësinë e secilit institucion ndëshkues-korrektues, t'i qaset zbatimit të menjëhershëm të të gjitha aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar. (2021 -2025) që kanë për qëllim realizimin e objektivit të 4-të strategjik: Sigurimi i një mjedisi të sigurt për personat e dënuar dhe personelin në INK dhe IEK;
- Praktikrat johumane dhe degraduese të përdorimit të rripave të lëkurës në Burgun Shkup dhe ENK Idrizovë, duhet të ndërpriten menjëherë;
- Kujdesi shëndetësor për të dënuarit, përfshirë edhe mbrojtjen e shëndetit mendor, duhet të jetë një nga prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve, institucioneve ndëshkuese-korrektuese dhe autoriteteve të tjera kompetente;
- Rritja e kuadrove në sektorët e risocializimit dhe profesionalizimi i tyre, duke siguruar njëkohësisht burimet e nevojshme për realizimin papengësë të aktiviteteve të trajtimit është obligim i DES që doemos duhet t'a përmbushë si parakusht i domosdoshëm nga i cili varet edhe realizimi i qëllimit të dënimit - risocializimi dhe adaptimi social i personave të dënuar;
- Është e domosdoshme që Ministria e drejtësisë dhe Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve të marrin masa konkrete për të siguruar që fëmijët e gjinisë femërore të cilave me vendim të formës së prerë u është shqiptuar masa edukative dërgim në ent edukues-korrektues, të akomodohen në institucion të dizajnuar në mënyrë të veçantë për ato dhe nevojat e tyre, në bazë të barabartë me fëmijët e gjinisë mashkullore;

- Ministria e arsimit dhe shkencës, në koordinim me DES, institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese, duhet t'i qasen realizimit të detyrimit për sigurimin e arsimit për çdo person të dënuar me burg dhe për çdo fëmijë që i është shqiptuar masa edukative - dërgim në ent edukues -korrektues;
- Në kujdesin për shëndetin mendor të fëmijëve në Entin edukues-korrektues Tetovë medoemos duhet të përfshihet edhe një psikiatër i specializuar për psikiatrinë e fëmijëve dhe adoleshentëve.

4

STACIONET POLICORE ME KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Të vepruarit me të arrestuarit, personat e privuar nga liria si dhe të ndaluarit në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme, ekipi i MPN-së e hulumtoi nëpërmjet realizimit të vizitave të paparalajmëruara në stacionet policore në rajonin e SPB Strumicë dhe SPB Ohër. Në këtë drejtim, në vitin 2021 ishin vizituar stacionet policore me kompetenca të përgjithshme në Strumicë, Radovish, Vallandovë, Gjevgjeli, si dhe në Kërçovë, Strugë, Ohër dhe Dibër.

Qëllimi i vizitave ishte hulumtimi i mundësisë që personat e ndaluar në stacionet policore të shfrytëzojnë të drejtën e avokatit, domethënë, pas vizitave të realizuara gjatë vitit 2020, në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme në rajonin e SPB Shkup, me theks të problematikës së njëjtë.

Pikërisht, mundësia që personi i cili gjindet në paraburgim policor të ketë të drejtën e avokatit e cila paraqet garancë themelore për parandalim të keq-veprimit dhe e promovon edhe kulturën e transparencës në lidhje me privimin nga liria, duke i inkurajuar pushtetarët që të respektojnë dinjitetin njerëzor të personit të ndaluar në procedurën policore

Të dhënat për numrin e të arrestuarëve, të privuarve nga liria dhe personave të ndaluar në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme në rajonin e SPB Strumicë dhe SPB Ohër të cilët e kanë shfrytëzuar të drejtën e thirrjes së avokatit në masë të gjerë janë identike edhe me të dhënat e Raportit të ekipit të MPN-së i cili ka të bëjë me qasjen deri te e drejta e avokatit në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme në rajonin e SPB Shkup të vitit 2020. Pikërisht, tek të arrestuarit dhe personat e privuar nga liria, ajo përqindje është nën ose rreth 5%, kurse te personat e ndaluar ajo është rreth 10-15%.¹⁸

¹⁸ Duhet të merret parasysh se personat e arrestuar të cilët kanë qenë të privuar nga liria, e të cilët kanë thirrur avokat shpeshherë janë ata të cilët kanë qenë të mbajtur, në atë drejtim kur të analizohet numri i të arrestuarëve dhe personave të privuar nga liria të cilët nuk janë mbajtur, do të fitohet numri mesatar i cili është edhe më i vogël se 5%.

Përqindja e vogël e cila rezulton me numrin e vogël të personave që e kanë shfrytëzuar të drejtën e avokatit në stacionet policore është e kundërta në proporcion me rrezikun e të vepruarit jo të drejtë/përkatës në stacionet policore dhe të drejton në nevojën e ndërmarrjes së masave konkrete të cilat do të kontribuojnë në efektimin e të drejtës për avokat në procedurën policore si qasje reale dhe faktike.

Gjatë kohës së vizitave ishte konstatuar se gjendja socio-ekonomike e personave të cilët shoqërohen në stacionet policore theksohet si një nga shkaqet kryesore për shkak të të cilave këto persona nuk vendosin të shfrytëzojnë të drejtën e avokatit. Njëkohësisht, ishte konstatuar se nuk ka mekanizëm juridik dhe faktik i cili është i zhvilluar mjaftueshëm i cili do të mundësojë që personave që duan, por vlerësojnë se nuk kanë mjaftueshëm mjete, të shfrytëzojnë të drejtën e avokatit në procedurën policore.

Nga aspekti normativo-juridik, Ligji për Procedurë Penale parashikon se personi i privuar nga liria dhe i ndaluar në stacion policor „*bnë kohën prej orës 20:00, në mbrëmje, deri 08:00, në mëngjes, ka të drejtën e avokatit nga lista e avokatëve kujdestar, të cilën e përpilon Dhoma e Avokatëve e Republikës së Maqedonisë. Hargjimet për avokatin kujdestar si mbrojtës në kohën e mbajtjes gjatë natës bien nën ngarkesë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.*”

Kjo dispozitë nuk parasheh përjashtime dhe ka të bëjë me të gjithë personat të cilët privohen nga liria dhe ndalohen në periudhën e theksuar. Dispozita e këtillë është parakusht i mirë normativ për qasje deri te e drejta e avokatit, për këshillë juridike pa pagesë, shërbim ose ndihmë për personat e privuar nga liria dhe të ndaluar në stacion policor. Megjithatë, në praktikë ekipi i MPN konstatoi se pothuajse as edhe një nga personat zyrtarë në stacionet policore nuk është i njoftuar me dispozitën, poashtu, as personat të cilët e kanë këtë të drejtë, nuk janë të informuar.

Gjatë kohës së vizitave, ngjashëm si edhe gjendja e notuar në vitin paraprak raportues në stacionet policore me kompetenca të përgjithshme në rajonin e SPB Shkup, ekipi i MPN konstatoi se madje edhe në këta raste të rralla kur në disa nga stacionet policore të cilat kanë lista të avokatëve kujdestar, ndonjë person i mbajtur do të paraqesë se dëshiron të thirrë avokat, ose në rastet kur është e obligueshme prezenca e avokatit (për shembull kur punohet për mbajtje ose bisedë me fëmijë në konflikt me ligjin), zyrtarët policor ballafaqohen me vështirësi që të sigurojnë prezencë. Pikërisht, avokatët shpeshherë nuk janë të kapshëm, ose gjejnë arsye të llojllojshme për shkak të të cilave nuk mundën të jenë prezent. Sipas zyrtarëve policor edhe këtu shkak i vërtetë për këtë është fakti se avokatët vlerësojnë se nuk iu paguhet shërbimi.¹⁹

¹⁹ Më tepër për këtë mund të shihet edhe te Komenti i Ligjit për Procedurë Penale, ku, midis tjerash, potencohet edhe ajo se: “... praktika tregon se avokatët nuk i vlerësojnë këtë lista si obligim serioz, por vetëm si shprehje e interesit. Patjetër të ekziston listë më e ngushtë e avokatëve të vërtetë kujdestar të cilët obligativisht do të paraqiten në thirrje. Përveç kësaj, kuptohet edhe ajo që Dhoma e Avokatëve duhet të sanksionojë mosparaqitjen e avokatëve, posaçërisht atyre kujdestar... Nuk është me më pak vlerë çështja në lidhje me buxhetin, përkatësisht, kush do të mbulojë hargjimet për avokat. LPP tani në mënyrë eksplicite parasheh se hargjimet për avokat nga lista e avokatëve kujdestar i cili do të angazhohet gjatë natës (ndërmjet orës 22, në mbrëmje, dhe orës 6, në mëngjes), do të bien barrë e Buxhetit Shtetëror, e cila nuk është mjaftueshëm precize (neni.161 paragrafi (1) i LPP)”.

Pa marrë parasysh nëse është ky shkaku i vërtetë i mos qasjes deri te avokati, vetë fakti që kjo situatë është e notuar në shumicën e stacioneve policore në rajon, në më së paku tre sektore të ndryshme për punë të brendshme, përdëfton në atë se bëhet fjalë për problem ndaj të cilit bashkarisht organet dhe organizatat kompetente t`i kushtojnë vëmendje.

Në këtë drejtim, AP-MPN rekomandon operacionalizimin e sistemit të mbrojtjes juridike i cili do të sigurojë mbrojtje në kohë, efektive dhe kualitative të personave të thirrur, të arrestuarit, personave të privuar nga liria si dhe personave të mbajtur në stacionet policore.

Gjatë kohës së vizitave kujdes i veçantë iu përkushtua edhe hapësirave të zyrtarëve policor, për të cilat ekipi i MPN-së ishte i informuar, apo vlerësonte se shfrytëzohen ose munden të shfrytëzohen si vende ku realizohen bisedat me të thirrurit, të arrestuarit dhe personat e privuar nga liria dhe të mbajtur. Gjatë inspektimit të gjendjes faktike ishin marrë parasysh edhe konstatimet e Komitetit Evropian për Prevenim nga Tortura me të cilat janë të notuar më shumë raste të personave të arrestuar të cilët janë ankuar për maltretim në stacionet policore në të cilat janë shoqëruar. Pikërisht, përskaj maltretim gjatë kohës së arrestimit, potencohen edhe raste në të cilat personat e arrestuar kanë qenë të maltretuar edhe në zyrat brenda në stacionet policore me qëllim të detyrimit që të pranojnë ose informatave tjera. Një pjesë e lëndëve në të cilat personat potencojnë se kanë qenë të sulmuar/qëlluar janë edhe toki-voki Motorola, llamba të ndryshme elektrike e të ngjashme.²⁰

Në këtë drejtim, ishte konstatuar se pjesa më e madhe e stacioneve policore, të cilat ishin vizituar, nuk posedojnë me hapësira të veçanta për biseda, për shkak të të cilëve, për këtë qëllim, shfrytëzohen zyrat e zyrtarëve të uniformuar policor, ose ata të inspektorëve, kur bëhet fjalë për vepra penale. Kështu është rasti me Stacionet Policore në Radovish, Vallandovë, Ohër, Strugë dhe Dibër. Në Stacionin Policor në Kërçovë një nga objektet është krejtësisht i rinovuar dhe në të MPN-ja vërejti hapësira të posaçme për ndalim dhe bisedim me persona, por gjatë kohës së vizitës ishte konstatuar se për pjesën e rinovuar të Stacionit Policor akoma nuk është realizuar pranimi teknik, dhe për këtë shkak ata hapësira aspak nuk shfrytëzohen. Në Stacionin Policor në Strumicë në afërsi të hapësirës së udhëheqësit të ndërrimit ka hapësirë e cila shfrytëzohet për biseda nga ana e zyrtarëve të uniformuar policor, por në rastet kur bëhet fjalë për persona të privuar nga liria dhe të shoqëruar në stacionin policor për shkak të marrjes në pyetje ose mbajtjes, inspektorët bisedat me këta persona i realizonin në zyrat e tyre zyrtare. Në Stacionin Policor Gjevgjeli në pjesën ku gjinden hapësirat për mbajtje ka edhe hapësira të veçanta për bisedë, pranë të cilave ka edhe hyrje të veçantë. Ky stacion policor është shembull i mirë se si duhet të jenë të pajisura hapësirat për biseda, duke e pasur parasysh se janë të pajisura me tavolina dhe karrike të përforcuara/statike dhe në vend të dukshëm janë të vendosur këshillat për të drejtat e të thirrurve, të arrestuarve dhe personave të mbajtur në më shumë gjuhë. Njëkohësisht, ka të vendosura edhe video kamera dhe janë të larguara të gjitha sendet tjera.

²⁰ Raporti CPT/Inf (2021) 8 nga vizitat e realizuara në Republikën e Maqedonisës së Veriut, i shpallur më 11 maj 2021, në lidhje me gjendjen e konstatuar gjatë kohës së vizitës në periudhën prej 2 deri 10 dhjetor 2019

Duke u bazuar në gjendjen e konstatuar, AP-MPN e shpreh nevojën që në të gjitha stacionet policore sa më shpejtë të përshtaten hapësira të veçanta për biseda të cilat do të pajisen me kamera për video-mbikëqyrje, tavolina dhe karrike të përforcuara/statike si dhe mjete tjera të nevojshme (postera me këshilla për të drejtat), prej të cilave do të largohen të gjitha sendet të cilat do të mund të shfrytëzohen për të frikësuar, maltretuar ose eventualisht për të lënduar veten. Njëkohësisht, është e nevojshme të bëhet kujdes i madh dhe në pajtim me Ligjin për të Drejtat e Fëmijëve, bisedat me fëmijët të realizohen në hapësira të veçanta konform moshës së tyre.

Në pjesën e të vepruarit me emigrantët, përkatësisht të huajt, është konstatuar se ata që janë gjetur në territorin i cili është nën kompetencë të stacioneve policore të lartpërmendura, menjëherë shoqërohen në Qendrat Pranuese Tranzite në Gjevgjeli dhe Tabanocë, pa u zbatuar procedurë adekuate për t`i informuar për të drejtat e tyre. Në rastet më të shpeshta, ata as që futen në stacionet policore, por mbahen përpara stacioneve policore (në rrethin e stacionit) derisa të arrijnë mjetet e udhëtimit të cilat do t`i transportojnë deri te ndonjë Qendër Pranuese. Në këtë drejtim, ata as nuk janë evidentuar si persona të cilët janë arrestuar nga ana e zyrtarëve policor nga stacionet konkrete policore. Ky "sigurim" mund të zgjasë prej 15 minuta deri disa orë.

Ekipi i MPN-së gjatë kohës së vizitave realizoi biseda edhe me një numër të madh të zyrtarëve policor, dhe për këtë shkak vlerëson se është e nevojshme që në këtë raport të potencohen edhe deklaratat e zyrtarëve policor në lidhje me kushtet dhe atmosferën e punës, si një nga faktorët i cili ndikon mbi shkallën e rrezikshmërisë nga akte të mundshme të torturës ose ndonjë lloj tjetër i sjelljes së vrazhdë, jo njerëzore, nënvlerësuese apo ndëshkuese.

Pikërisht, një pjesë e madhe e ankesave të zyrtarëve policor kishin të bënin me mungesën e uniformave zyrtare dhe mbathjeve, dhe për këtë shkak kanë qenë të detyruar të gjinden disi dhe të blejnë ose huazojnë nga kolegët. Në këtë drejtim, numri më i madh i zyrtarëve të uniformuar policor potencuan se personalisht i blejnë mbathjet sipas mundësive personale, e gjitha mund të vërehet se edhe uniformat dallohen, në drejtim të asaj se disa ishin më të reja, disa shumë më të vjetra, ose siç personalisht tregojnë "ashtu siç kanë mundur të gjinden".²¹

Ankesa ishin pranuar edhe në lidhje me kushtet materiale në të cilat çdo ditë realizojnë obligimet e punës. Ekipi i MPN-së gjatë kohës së vizitave konstatoi se vërtetë numri më i madh i zyrtarëve është i mobiluar me mobilje të vjetra si dhe me inventarë të vjetër (biro pune të vjetra, karrike të thyera, dollapë të cilët nuk kyçen e të ngjashme). Në më shumë zyra ishte konstatuar se janë të sitemuar më shumë zyrtar policor se sa ka karrike dhe biro pune, për këtë shkak janë të detyruar që t`i ndajnë, apo të gjenden disi. Një pjesë e zyrtarëve policor u ankuan edhe për mungesën e mjeteve bazë për punë, si për shembull, mugesë e kompjuterit si dhe materialeve tjera administrative. Një numër i madh i zyrtarëve policor potencuan se "janë mësuar me kushtet" dhe "janë ballafaquar me realitetin", por njëkohësisht nuk e fshihnin dëshpërimin nga ajo, si edhe nevojën e përmirësimit të kushteve.

Në pjesën e atmosferës në punë, më shumë zyrtarë policor me të cilët u bisedua në

besim, potencuan se në suaza të shërbimit ndjejnë shtypje dhe ndikime të ndryshme (midis tjerash edhe të natyrës politike), si suptile ashtu edhe të drejtpërdrejta. Si pjesë e formës manifestuese ishin të potencuara sistemime në pozicione tjera në punë (ose në qytete tjera) ose kërcënime të tilla, si dhe sistemim jo adekuat në punë.

Një pjesë e zyrtarëve policor potencuan se në punën e tyre dhe në suaza të realizimit të kompetencave të tyre ballafaqohen edhe me kërcënime të ndyshme, presione dhe orvatje që të ndikojnë në pjesën e të vepruarit konkret dhe realizimin e kompetencave të tyre nga ana e "të fuqishmëve lokal". Në këtë drejtim, një pjesë e zyrtarëve policor potencuan dhe shembuj konkret, të cilët udhëzojnë në atë se këta "të fuqishëm", në të vërtetë, janë persona të cilët duke u thirrur në pozitën e tyre zyrtare apo shoqërore, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi nëpërmjet personave tjerë, u përdëftojnë se si presin që ata të veprojnë në suaza të autorizimeve të tyre gjatë punës, ndonjëherë duke shprehur kërcënim të tipit të paralajmërimit se do të mund të ballafaqohen me pasoja të ndryshme. Lloji i këtillë i shtypjes dhe orvatjes që të ndikojnë në punën e zyrtarëve policor shpeshherë mbesin të paparaqitura, sepse, siç potencuan "nuk besojnë se diçka do të ndryshojnë me atë".

Duke i notuar citatet e këtilla të shprehura drejtpërdrejt nga ana e zyrtarëve policor, jo vetëm nga stacionet policore të cilat ishin të vizituara në vitin 2021, AP-MPN shpreson se Ministra e Punëve të Brendshme do të ndërmarrë masa konkrete me të cilat do të inkurajojë zyrtarët policor që të paraqesin këto dukuri, presione, ndikime dhe kërcënime ndaj të cilave janë të ekspozuar, njëkohësisht do të ndërmerren edhe aktivitete tjera deri te motivimi më i lartë për punë si dhe profesionalizim të zyrtarëve policor.

²¹ Ekipi i MPN-së e ka parasysh informatën e publikuar nga ana e MPB -së se janë siguruar uniforma të reja dhe në atë drejtim i vlerëson përpjekjet për përmirësimin e kushteve të zyrtarëve të uniformuar policor. I shpallur në <https://mvr.gov.mk/vest/17758> „Konkretisht, për pajisjen e policisë së uniformuar janë siguruar 10.000 pallto dimërore dhe 8550 çizme të specializuara dhe dorëzimi i tyre pritet në fillim të vitit, 20.000 pantallona verore dhe dimërore, 10.000 këpucë me lëkurë të trashë dhe 20.000 kapela verore dhe dimërore të cilat duhet të dorëzohen gjatë rrjedhës së muajit vijues dhe 10.000 këmisha me mëngë të shkurtëra dhe 10.000 këmisha me mëngë të gjata, 8.000 maica polo, 10.000 këpucë gjysëm të larta dhe 8.000 këpucë me lëkurë të hollë dhe jelekë fluorescent.

Konstatimet dhe rekomandimet e përgjithshme nga vizitat e kryera në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme në rajonin e SPB Ohër dhe SPB Strumicë

Gjendje të konstatuara

- Numër i vogël i personave që e kanë shfrytëzuar të drejtën për avokat në procedurë policore që rrit rrezikun nga tortura dhe lloji tjetër i veprimit jopërkatës ndaj personave të privuar nga liria, të arrestuar dhe të mbajtur në stacionet policore;
- Mekanizëm juridik dhe faktik i zhvilluar jo mjaftueshëm që do t'u mundësojë personave që dëshirojnë, por mendojnë se nuk kanë mjete të mjaftueshme, të shfrytëzojnë të drejtën e avokatit në procedurë policore;
- Stacionet policore: Ohër, Strugë, Dibër, Radovish, Vallandovë nuk kanë dhoma të veçanta për biseda me persona të thirrur, të arrestuar, të privuar nga liria dhe të mbajtur;
- Punonjësit e policisë po ballafaqohen me lloje të ndryshme presionesh dhe përpjekjesh për të ndikuar në kryerjen e detyrave të tyre.

Rekomandime për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara

- MPB të marrë masa konkrete që do të kontribuojnë në realizimin e të drejtës për avokat në procedurën policore si reale dhe faktikisht e arritshme. Personat e thirrur dhe të arrestuar, si dhe personat e mbajtur duhet të informohen për të drejtën e tyre për të thirrur një avokat sipas zgjedhjes së tyre ose të zgjedhin nga lista e avokatëve kujdestarë. Ky detyrim duhet respektuar veçanërisht në rastet kur zhvillohen biseda me fëmijë ose kur bëhet fjalë për mbajtjen e fëmijëve që janë në konflikt me ligjin;
- MPB, në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë dhe organet e tjera kompetente, të marrin masa legislative, administrative dhe të tjera për të krijuar një mekanizëm juridik dhe faktik që do t'u mundësojë personave që duan, por nuk kanë mjete të mjaftueshme, të shfrytëzojnë të drejtën për avokat në procedurë policore;
- Është e nevojshme në të gjitha stacionet policore MPB-ja të adaptojë dhoma të posaçme për biseda të cilat do të pajisen me kamera për video-mbikëqyrje, tavolina e karrige të fiksuara dhe gjëra të tjera të nevojshme (posterë me udhëzime për të drejtat), prej ku do të hiqen të gjitha sendet që do të mund të përdoren për frikësim, maltretim ose vetëlëndim të mundshëm. Në të njëjtën kohë, duhet pasur parasysh se, në përputhje me Ligjin për drejtësi për fëmijët, bisedat me fëmijët duhet të zhvillohen në dhoma të veçanta të përshtatshme për moshën e tyre;

- MPB të rrisë komunikimin dhe të përmirësojë bashkëpunimin me punonjësit e policisë, me qëllim të ngritjes së nivelit të besimit të ndërsjellë, në këtë mënyrë do të inkurajojë punonjësit e policisë që të paraqesin presionet, ndikimet dhe kërcënimet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe në të njëjtën kohë të marrin aktivitete të tjera që do të çojnë në motivim më të madh për punë dhe profesionalizëm të punonjësve të policisë.

5

STACIONE POLICORE PËR KONTROLL KUFITARE SI DHE MBIKËQYRJE KUFITARE

Stacionet policore për kontroll kufitare dhe mbikëqyrje kufitare nuk janë të parapara si stacione policore në të cilat do të mund të realizohet mbajtja e personave në përputhje me "Aktvendimin e përcaktimit të stacioneve policore për mbajtjen e personave",²² por në pajtim me autorizimet ligjore të cilat i kanë zyrtarët policor për privim nga liria si dhe arrestimin e personave, në të njëjtat realizohet mbajtje e shkurtër e personave deri në dorëzimin e tyre në ndonjë stacion policor i cili është caktuar për atë. Gjithashtu, në përputhje me Ligjin për Kontroll Kufitare, zyrtarët policor gjatë realizimit të kontrollës kufitare të personave, përskaj tjerash, kanë autorizime që të njëjtët t`i mbajnë aq kohë sa nevojitet që të realizohet kontrolli kufitare, por jo më gjatë se 24 orë.²³

